



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BRENDSHME**  
**AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

**Nr. 52/33 Prot.**

**Tiranë më, 26/09/2024**

**V E N D I M**

**Nr. 45, datë 26.09.2024**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

**Bora Vrenjo**      **Kryesuese**  
**Henri Naqellari**      **Relator**  
**Loreta Hanxhari**      **Anëtare**

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Ersila Kalaja, në orën 10:30, datë 26.09.2024, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I VLERËSIMIT:**

**Z. Besnik Ferit Baku**, me funksion Drejtor, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**OBJEKTI:**

**Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

## TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji relatimin e relatorit të çështjes Henri Naqellari, dëgjoji subjektin e vlerësimit Z. Besnik Feriut Bakiu, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 19.09.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbrojtjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbrojtjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 2, nenit 4 dhe nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, Z. Besnik Bakiu është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbrojtjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023, si Drejtor, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Besnik Bakiu**, i’u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1, datë 02.08.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, përbërë nga: Z. Henri Naqellari Relator, Znj Bora Vrenjo Kryesuese dhe Znj Loreta Hanxhari Anëtar.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin nr. 1, datë 02.08.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Bakiu.
6. Relatori i çështjes, Z. Henri Naqellari, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 03.08.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka njoftuar relatorin e çështjes nëpërmjet emailit të datës 09.08.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Bazuar në nenin 34, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
11. Në përputhje me nenin 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI, me shkresë nr. \*\*\*, prot datë 18.03.2024 (protokolluar me tonën nr. \*\*\*, prot., datë 21.03.2024), dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të vlerësimit Besnik Baku. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri është konstatuar se:
  - Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
  - Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
  - Nuk është kryer deklarim i remë;
  - Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
12. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 22.12.2023, ka dërguar raportin e saj për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të vlerësimit Besnik Baku.
13. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke analizuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i vlerësimit gjatë periudhës objekt vlerësimi, të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, me shkresë nr. \*\*\*, datë 01.09.2023 (protokolluar me tonën nr. \*\*\*, prot., datë 06.09.2023), ka dërguar një raport


të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konkluduar se:


- Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- Ka aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës;
- Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

**14.** Në vijim relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tre kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

**15.** Trupa e Vlerësimit, më datë 05.09.2023, pasi dëgjoji relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Bakiu, me Vendimin nr. 03, datë 05.09.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Bakiu;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

 *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*

 *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, nenet 35-40 dhe nenet 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

**16.** Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, të Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**17.** Subjekti i vlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike, me njoftimin e bërë elektronikisht me email, në datën 17.09.2024.

**18.** Seanca dëgjimore me subjektin e vlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën 19.09.2024, ora 09:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, në prani të sekretariatit teknik.

**19.** Subjekti i vlerësimit Z. Besnik Bakiu, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur opinionin individual në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim, subjekti kërkoi nga Trupa e Vlerësimit konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT**

- 20.** Subjekti i vlerësimit Z. Besnik Baku, ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.
- 21.** Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **PROCESI I VLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT**

**22.** Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:

- Vlerësimin e pasurisë;
- Kontrollin e figurës;
- Vlerësimin e aftësive profesionale.

**22.** Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar;
- Ligjin nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- Ligjin nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
- Ligjin nr. 49/2012, “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
- Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
- Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”;
- Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Provat dhe shpjegimet e subjektit të vlerësimit;
- Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit;
- Raportin e dorëzuar nga ILDKPKI;
- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë AMP-së;
- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Deklarata e Pasurisë;
- Deklarata për Kontrollin e Figurës;
- Formulari i Vlerësimit Profesional;
- Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

24. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
25. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Besnik Baku**, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve të përcaktuara dhe mban nr. index 28, viti 2023.
26. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
27. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
28. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të nenit 33/1 dhe nenit 34, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.

Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

### **Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaramet e subjektit, si dhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

### **Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;

- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe rasteve të konfliktit të interesit.

## **Deklarimi i pasurisë**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/a, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose me persona të tjerë si më poshtë:

- pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to;
- sendet me vlerë të veçantë mbi 300.000 lekë;
- vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- vlerën e likuiditeteve, gjendje në kesh jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari, në huadhënie, apo mjete të tjera financiare, në lekë ose në valutë të huaj;

Në deklaratën Veting, të dorëzuar në strukturat përgjegjëse, subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si në vijim:

1. Apartament banimi me sip. 135, 76 m<sup>2</sup>, rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Blerë më 07.04.1999 te shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. Hipotekuar më datë 24.07.2013, në Zk. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*. Vlera 48.500 usd. Pjesë takuese 100%.

### **Burimi i krijimit:**

- Nga shitja e shtëpisë që prindërit e mi Ferit Bakiu dhe Hasije Bakiu kishin privatizuar në bazë të Ligjit “Për privatizimin e banesave”, në lagjen “30 vjetori”, Berat.
- Nga kursimet e familjes time nga pagat, shpërblimet etj.
- Nga ndihma e prindërve të bashkëshortes Veli Toto dhe Fatmira Toto, të cilëve u lamë në përdorim (pa afat dhe pa shpërblim), 2/4 e apartamentit të banimit, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Privatizuar më 20.09.1993.

**Bashkëlidhur deklaratës:** Certifikatë për vërtetim pronësie datë 18.09.2013, të pasurisë apartament, me sip. 135, 76 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. \*\*\*, Zk. \*\*\*, në pronësi të Besnik Bakiu, ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, G. \*\*\*, H. \*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë.

### **Procedura e vlerësimit:**

**ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2023, konfirmon pasurinë apartament, me sip. 135, 76 m<sup>2</sup>, Zk. \*\*\*, në emër të Besnik Bakiu. Bashkëlidhur ndodhet kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, regjistruar në datë 18.09.2013, në emër të Besnik Bakiu. Vlera fillestare 48.500 usd.

**ASHK, Drejtoria Vendore Berat**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, nuk konfirmon pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se në blerjen e apartamentit, kanë marrë pjesë së bashku me babain e tij të ndjerë, me kontribut të barabartë. Nuk disponon mandat pagesë pasi pagesa është kryer cash. Burimi i financimit të këtij apartamenti kanë qenë kursimet familjare nga viti 1983 deri në momentin e blerjes së apartamentit, si dhe shitja e apartamentit të përfutur nga privatizimi në qytetin e Beratit në vitet '90, shitur në gusht 1998, në vlerën 20.000 usd, për të cilin nuk disponon dokumentacion. Mobilimi i apartamentit ka qenë rreth 700.000 lekë dhe është paguar nga prindërit e bashkëshortes si suport ekonomik. Gjithashtu kanë shpenzuar për pajisje elektroshtëpiake vlerën 2.000 euro.

**Paraqiti:** Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 07.04.1999, palë sipërmarrëse shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k, përfaqësuar nga administratori A. R, palë porositëse Ferit Bakiu dhe Besnik Bakiu të një apartamenti me sip. 135, 76 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rr. "\*\*\*\*". Vlera e apartamentit do të jetë 48.500 usd, të cilat i janë paguar cash sipërmarrësit.

Me postën elektronike të datës 21.02.2024, subjekti sqaroi se, pas ndarjes nga jeta të nënës së tij Hasije Bakiu, babai Ferit Bakiu për të mos krijuar probleme familjare pas ndarjes së tij nga jeta, vendosi t'i dhuronte atij të gjithë të drejtat në kontratën e sipërmarrjes së sipërcituar. Kjo vërtetohet me autorizimin e lëshuar nga ndërtuesi/shitësi i këtij apartamenti A. R dhe noteri i vërtetimit të nënshkrimit Y. Ç, me aktin nr. 1521 rep., datë 10 tetor 2012.

**Subjekti i vlerësimit ka paraqitur:** Autorizim datë 10.10.2012, i shtetasit A. R (në cilësinë e administratorit/ortakut të shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k), nënshkruar para noterit, sipas vërtetimit të nënshkrimit nr. 1521 rep., datë 10.10.2012, në të cilën autorizohet shtetasi Besnik Bakiu, të aplikoj pranë ZRPP Tiranë, për regjistrimin e kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 07.04.1999, pasi porositësi tjetër Ferit Bakiu, ja ka dhuruar të drejtat e tij të birit Besnik Bakiu. Porositësi i ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj sipërmarrësit të shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k., për apartamentin me sip. 135, 76 m<sup>2</sup> që ndodhet në rr. "\*\*\*\*", Tiranë.

Me procesverbalin e datës 28.02.2024, subjekti sqaroi se, të dy prindërit pas shitjes së apartamentit të tyre në Berat, largimit nga bashkëjetesa me prindërit e bashkëshortes dhe ndarjes në një banesë më vete, erdhën në Tiranë dhe jetuan me të. Kontributi për shpenzimet e mobilimit kanë qenë nga prindërit e bashkëshortes 700.000 lekë dhe 2.000 euro për elektroshtëpiake.

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultun:

- ***Pasuria apartament me sip. 135, 76 m<sup>2</sup>, në rr. "\*\*\*\*", Tiranë, është blerë me kontratë sipërmarrje në vitin 1999 nga subjekti dhe babai i tij kundrejt vlerës 48.500 usd, me burim të ardhurat familjare dhe shitja e apartamentit të përfutur nga privatizimi në qytetin e Beratit.***



- Në vitin 2012, subjekti autorizohet për të regjistruar apartamentin në emër të tij, pasi është dhuruar nga babai pjesa e tij takuese.
- Nuk disponohet dokumentacion për shitjen e apartamentit në Berat si dhe mungon dokumentacioni i plotë ligjor për të vërtetuar të ardhurat e realizuara deri në momentin e blerjes së apartamentit.
- ASHK Tiranë konfirmon apartamentin e deklaruar nga subjekti.
- ASHK Berat, nuk konfirmon pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit.
- Shpenzimet e mobilimit të apartamentit janë deklaruar në shumën rreth 928.000 lekë.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e deklaruara nga shitja e apartamentit të prindërve në Berat, i përfituar nga privatizimi, deklaruar si burim pjesor i blerjes së apartamentit me sip. 135, 76 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në vitin 1999, me vlerë 48.500 usd, për të cilën është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

2. Gjendje cash. Vlera 10.000 euro. Pjesë takuese 100%.

Burimi i krijimit: Kursime familjare ndër vite.

### Procedura e vlerësimit:

**Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.09.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Baku ka patur llogari aktive në dollar në ish Bankën Italo Shqiptare, në të cilën në datë 13.04.2001 ka depozituar cash shumën 20.000 usd, vlerë të cilën e ka investuar në depozitë me afat dhe e ka tërhequr cash në datë 19.04.2007, në vlerën 22.525 usd.

Subjekti i vlerësimit ka patur një llogari tjetër në dollar pranë kësaj banke, ku gjenden transaksionet si më poshtë:

- Në datë 16.09.2002, depozituar shuma 300 usd,
- Në datë 24.10.2002, depozituar shuma 900 usd,
- Në datë 12.11.2003, depozituar shuma 2.000 usd,
- Në datë 31.12.2004, depozituar shuma 600 usd,
- Në datë 11.02.2005, depozituar shuma 222 usd,
- Në datë 21.11.2006, tërhequr shuma 5.494 usd,
- Në datë 19.04.2007, depozituar shuma 22.507 usd,
- Në datë 19.04.2007, transferuar shuma 22.507 usd, në depozitë me afat,
- Në datë 25.04.2014, tërhequr cash shuma 26.123 usd.

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Baku ka patur depozitë 12 mujore, çelur në datë 23.04.2007, në shumën 22.500 usd, deri në datë 25.04.2012, kur vlerën e maturuar prej 25.358 usd e transferon në një depozitë tjetër me afat 24 mujor. Në datë 27.04.2020 depozita tërhiqet totalisht cash në shumën 24.498 usd.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se në vitin 2001, ka çelur një depozitë me vlerë 20.000 usd, burimi financiar i së cilës kanë qenë kursimet familjare, nga viti 1983 i fillimit të marrëdhënieve të punës, përfitimet nga firmat piramidale, pagesat si ekspert pranë OJF-ve të

ndryshme dhe institucioneve ndërkombëtare, si dhe pagesat e përfituara si përfaqësues me prokurë të shtetasit me banesë në Zvicër, të ndjerit Gj. M, pranë Komisionit të Kthimit të Pronave në Tiranë dhe Korçë për shitjen e disa pronave. Me porosi të pronarit, ka realizuar shitjen para vitit 2000 të dy dyqaneve në qendër të Korçës (godina e shtetas A. I. T), që Komisioni i Kthimit të Pronave të Korçës i kishte kthyer të ndjerit. Në kujtesën e tij, subjekti deklaron se kontratat janë nënshkruar në Tiranë dhe Korçë. Blerësit kanë qenë shitësit që i kishin në përdorim këto ambiente. Për të gjitha veprimet e kryera prej tij, nuk ka dokumentacion por ato (objektet) janë prezente edhe sot në qytetin e Korçës. Shuma financiare e përfituar nga subjekti ka qenë 10 % – 15 % e të ardhurave të përfituara nga porositësi, që duhet të ketë qenë diku tek 25.000 usd. Në 25.04.2014 depozita është tërhequr totalisht në vlerën 26.123 usd, për nevoja familjare, shkollimin e vajzës në Belgjikë si dhe diferencat janë aktualisht gjendje cash në shtëpi.

Gjithashtu subjekti sqaroi se në vitin 2007 ka çelur një depozitë me vlerë 22.500 usd, burimi financiar i së cilës kanë qenë kursimet familjare si dhe honoraret që ka përfituar nga OJF-të e ndryshme si dhe institucionet ndërkombëtare. Depozita është tërhequr prej tij në vitin 2020 në vlerën 24.498 usd. Një pjesë e kësaj depozite është përdorur për shpenzimet e universitetit të vajzës dhe diferenca është mbajtur gjendje cash në shtëpi. Si burim krijimi i kësaj shume, subjekti sqaroi se ka qenë dhe një shumë që prindërit e ndjerë kishin lënë në shtëpi, që u gjet pas ndërrimit të jetës.

#### **Paraqiti:**

- Kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 13.03.1996, nënshkruar ndërmjet Vefa Holding Group dhe huadhënësit Besnik Bakiu, të shumës 2.000 usd, afat 6 muaj, interes 6% në muaj.
- Kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 17.09.1996, nënshkruar ndërmjet Kamberi Company dhe huadhënësit Besnik Bakiu, të shumës 1.000 usd, afat 6 muaj, duke filluar nga data 17.09.1996, interes 8% në muaj.
- Foto të dyqaneve në Korçë.
- Kontratë për llogarinë e kursimeve “Fonde për të ardhmen e fëmijës”, në Intesa SanPaolo Bank, çelur më datë 15.12.2006, në emër të Krist Bakiu. Vlera 10.000 usd.
- Kontratë për llogarinë e kursimeve “Fonde për të ardhmen e fëmijës”, në Intesa SanPaolo Bank, çelur më datë 15.12.2006, në emër të Keti Bakiu. Vlera 10.000 usd.

#### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se subjekti i vlerësimit:

- *Ka investuar në firmat piramidale shumë prej 3.000 usd gjatë vitit 1996.*
- *Ka investuar në institucionet bankare nëpërmjet depozitave, në total shumë rreth 67.865 usd gjatë periudhës 2001 – 2007, dhe për këtë arsye aplikohet neni 32, pika 1.1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*
- *Nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me vlerën 25.000 usd të përfituara nga shtetasi Gj. M, përdorur si burim financiar të një pjese të vlerave të investuara, për të cilat është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

- *Pakësimi i depozitave bankare ka pasur si destinacion krijimin e gjendjes cash, si dhe shpenzime të tjera familjare (arsimim, shpenzime jetike).*
3. Llogari page në Tirana Bank, me gjendje në datë 17.02.2023, në vlerën 32.720,38 lekë. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: Kursimet nga paga.

**Bashkëlidhur deklaratës:** Lëvizjet e llogarisë së pagës në emër të Besnik Bakiu në Tirana Bank, gjatë periudhës 01.01.2011 - 22.02.2023. Gjendje në llogari datë 22.02.2023 në vlerën 4.685,9 lekë.

#### **Procedura e vlerësimit:**

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari në emër të shtetasit Besnik Bakiu me gjendje në datë 10.03.2023, në vlerën 32.720 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se *nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.*

4. Llogari shumë emërore me vajzën time, në Tirana Bank, me gjendje në datë 24.02.2023, në vlerën 3.144,37 euro. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: Kursimet nga paga.

#### **Procedura e vlerësimit:**

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari të përbashkët në emër të Keti dhe Besnik Bakiu, me gjendje në datë 10.03.2023, në vlerën 3.143,97 euro.

Nga verifikimi i llogarisë bankare konstatohen transaksione financiare ndër vite, depozitime cash kryesisht të kryera nga subjekti i vlerësimit dhe vajza e tij Keti Bakiu, konkretisht:

- Për vitin 2019, shuma 12.120 euro;
- Për vitin 2020, shuma 9.500 euro;
- Për vitin 2021, shuma 9.000 euro;
- Për vitin 2022, shuma 10.900 euro;

Lidhur me këto transaksione, subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegime më poshtë, pasi lidhen me shpenzimet për arsimimin e vajzës Keti Bakiu.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se *nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit dhe personit të lidhur me të. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.*

## **Deklarimi i të ardhurave financiare ndër vite të subjektit të vlerësimit**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/b, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të ardhurat nga paga, nga angazhime në veprimtari private dhe/ose publike, me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie të kryer brenda dhe jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, licenca dhe patenta, që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën nga momenti i fillimit të detyrës deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Sa më sipër subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor. Viti 2023. Shuma e të ardhurave 249.451 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Sektorin e Trajnimit dhe Përgatitjes në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, periudha 13.01.2015 - 2022. Shuma e të ardhurave 7.008.481 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Sektorin e Administratës e Mbështetjes, Mbështetjes Mësimore, Sektorin e Trajnimit, Shkollimit për Gradë dhe Nivel në Qendrën e Formimit Policor, periudha 11.06.2010 - 12.01.2015. Shuma e të ardhurave 4.165.905 lekë.
- Të ardhura nga Pension i Parakohshëm për periudhën 16.09.2009 - 11.06.2010. Shuma e të ardhurave 190.308 lekë.
- Të ardhura nga pagesë kalimtare për periudhën 16.09.2006 - 16.09.2009. Shuma e të ardhurave 1.764.000 lekë.
- Të ardhura nga DPQ Lezhë, Sektori i Kufirit dhe Migracionit, periudha 25.04.2006 - 16.09.2006. Shuma e të ardhurave 363.991 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Qendrore të Policisë Kufitare dhe Migracionit, periudha 01.10.2004 - 25.04.2006. Shuma e të ardhurave 1.306.669 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Qendrore të Policisë Kufitare dhe Migracionit, periudha 16.05.2001 - 01.10.2004. Shuma e të ardhurave 1.828.433 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë e Policisë Kufitare në MRP, periudha 05.01.1999 - 16.05.2001. Shuma e të ardhurave 907.815 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Rajonin e Rinasit Tiranë, periudha 01.12.1997 - 01.04.1998, 20.10.1998 - 05.01.1999. Shuma e të ardhurave 75.800 lekë.
- Të ardhura nga qëndrimi në Dispozicion Ministria e Brendshme, periudha 01.04.1998 - 01.08.1998. Shuma e të ardhurave 60.000 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Repartin e Sigurimit të Vlerave Monetare, periudha 15.08.1993 - 01.12.1997. Shuma e ardhurave 640.283 lekë.
- Të ardhura nga punësimi si Sekretar Rinie, Komandant Toge, Komandant Kompanie në Repartin nr. 324 Tiranë, periudha 01.02.1984 - 15.08.1993. Shuma e të ardhurave 96.755 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në Pikën Kufitare Lin Pogradec, periudha 16.07.1983 - 01.02.1984. Shuma e të ardhurave 4.225 lekë.
- Të ardhura si Lektor/Studiuues/Ekspert, në Institutin për Studimet Publike e Ligjore, periudha mars 2002 - janar 2003. Shuma e të ardhurave 391.745 lekë.
- Të ardhura si Lektor/Ekspert në Projektin e Binjakëzimit BE-Shqipëri, viti 2005. Shuma e të ardhurave 6.700 euro.

- Të ardhura si Lektor/Ekspert në projektin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, periudha qershor 2006 - prill 2008. Shuma e të ardhurave 675 euro.
- Të ardhura si Ekspert në projektin e zhvilluar nga Mbështetja e Iniciativave Lokale për Zhvillim, viti 2007. Shuma e të ardhurave 1.800 euro.
- Të ardhura si Ekspert në projekte të ndryshme për të Drejtat e Njeriut, nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, periudha 1995 - 2007. Shuma e të ardhurave 2.700 usd.
- Të ardhura si Ekspert në projektin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, periudha qershor 2006 - prill 2008. Shuma e të ardhurave 720 euro.
- Të ardhura si Lektor/Ekspert në projektin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, periudha qershor 2006 - prill 2008. Shuma e të ardhurave 760 euro.
- Të ardhura si Lektor/Ekspert në projektin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, periudha qershor 2006 - prill 2008. Shuma e të ardhurave 950 euro.
- Të ardhura si Anëtar Bordi Këshillimor në projektin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, viti 2010. Shuma e të ardhurave 150 usd.
- Të ardhura si Ekspert në projektin e organizuar nga Risk Monitor Foundation Sofie. Shuma e të ardhurave 1.350 usd.
- Të ardhura si Këshilltar pranë Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, viti 2012. Shuma e të ardhurave 900 usd.
- Të ardhura si Lektor/Stудиues/Ekspert në Institutin për Studimet Publike e Ligjore, periudha 22.04.2013 - 10.09.2013. Shuma e të ardhurave 3.150 euro.
- Të ardhura si Lektor/Stудиues/Ekspert në Institutin për Studimet Publike e Ligjore, periudha 01.04.2013 - 01.11.2013. Shuma e të ardhurave 320.000 lekë.
- Të ardhura si recensues i studimit “Vlerësimi i Riskut të Krimin të Organizuar në Shqipëri”, F. Zhilla e B. Lamallari. Shuma e të ardhurave 493 usd.
- Të ardhura si Lektor/Asistent në projektet kulturore të OJF “Poetika”, periudha 2012 - 2013. Shuma e të ardhurave 225.000 lekë dhe 200 euro.
- Të ardhura si honorarë nga Shkolla e Magjistraturës, dhjetor 2013. Shuma 18.000 lekë.
- Të ardhura si Lektor/Stудиues/Ekspert në Institutin për Studimet Publike e Ligjore, periudha 01.09.2015 - 01.02.2016. Shuma e të ardhurave 290.000 lekë.
- Të ardhura si Lektor/Stудиues/Ekspert në Institutin për Studimet Publike e Ligjore, periudha 15.12.2015 - 15.07.2016. Shuma e të ardhurave 4.000 usd.
- Të ardhura si Lektor/Stудиues/Ekspert në Institutin për Studimet Publike e Ligjore, periudha 01.05.2017 - 30.04.2018. Shuma e të ardhurave 6.629 usd.
- Të ardhura si Lektor/Stудиues/Ekspert në Institutin për Studimet Publike e Ligjore, periudha janar 2018 - 31.03.2018. Shuma e të ardhurave 2.100 euro.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Lëvizjet e llogarisë së pagës në emër të Besnik Bakiu në Tirana Bank, në të cilën janë kredituar pagat, gjatë periudhës 01.01.2011 - 22.02.2023.
- Vërtetim nga Ministria e Brendshme, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Besnik Bakiu, gjatë periudhës gusht 1998 - qershor 2001, në shumën totale prej 619.570 lekë.
- Vërtetim për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Besnik Bakiu pranë Aparatit të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, gjatë periudhës 01.07.2001 - 30.4.2006. Për periudhën 01.7.2001 - 31.12.2005, në total shuma 2.880.327 lekë.

- Librezë për përfitim suplementar të Policisë së Shtetit nga Besnik Bakiu, nga data 01.07.2009. Vlera e pensionit mujor 18.585 lekë.
- Urdhër nr. 778, datë 07.04.2003, i Ministrisë së Rendit Publik për shpërblimin e Major Besnik Bakiu, me 2 paga mujore.
- Vërtetim nga Instituti për Studimet Publike e Ligjore për shtetasin Besnik Bakiu, i cili është kontraktuar në cilësinë e lektorit/studiuesit/ekspertit për projekte te ndryshme dhe ka realizuar të ardhura për periudhat: mars 2002 - janar 2003, në vlerën 391.745 lekë; 22 prill 2013 - 10 shtator 2013, në vlerën 3.150 euro; 15 dhjetor 2015 - korrik 2016, në vlerën 4.000 usd; 1 prill 2013 - 1 nëntor 2014, në vlerën 320.000 lekë; 1 shtator 2015 - 1 shkurt 2016, në vlerën 290.000 lekë; 1 janar 2018 - 31 mars 2018, në vlerën 2.100 euro; 1 maj 2017 - 3 prill 2018, në vlerën 6.629 usd.
- Vërtetim nr. 176, prot., datë 21.02.2018, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit për Besnik Bakiu, i cili është aktivizuar si ekspert me kohë të pjesshme, në fushën e emigracionit. Lidhur me projektet e zhvilluara, gjatë periudhës qershor 2006 - prill 2008 është paguar në vlerën totale prej 2.385 euro. Për të gjitha pagesat për të, paguar 10% detyrimin ligjor të tatimit mbi shërbimet.
- Kontratë shërbimi datë 15.06.2011, ndërmjet Komitetit Shqiptar të Helsinkit OJF dhe Besnik Bakiu, ekspert. Objekti i shërbimit është trajnimi që do të zhvillohet në datat 22 e 23 qershor 2011. Ekspertit i paguhet pas përfundimit të trajnimit, shuma 300 euro.
- Vërtetim nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë datë 16.02.2018, për të ardhurat neto të shtetasit Besnik Bakiu pranë këtij institucioni. Në vitin 2010, shuma 150 usd; në vitin 2012, shuma 900 usd dhe në vitin 2015, shuma 493 usd.
- Kontratë shërbimi e nënshkruar në datë 13.06.2011, ndërmjet Risk Monitor Foundation dhe Besnik Bakiu. Sipas kontratës, këshilltari Besnik Bakiu për projektin që do të zhvillohet, do të përfitojë një pagesë të vetme në vlerën 500 usd.
- Certifikata dhe manuale me pjesëmarrje të shtetasit Besnik Bakiu, në rolin e ekspertit.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Besnik Bakiu dhe pagat e kredituara gjatë periudhës janar 2006 - korrik 2009 dhe korrik 2010 - shkurt 2011, në vlerën totale rreth 2.730.000 lekë.

Gjithashtu, konfirmohen në emër të subjektit:

- Llogari në euro, në të cilën janë kredituar pagesat si ekspert, nga Instituti i Studimeve Publike e Ligjore, gjatë periudhës maj 2018 - maj 2019, në shumën totale prej 9.605 euro.
- Llogari në usd, në të cilën janë kredituar pagesat si ekspert/drejtues projekti, nga Risk Monitor Foundation, QRPK & TP, gjatë periudhës tetor 2011 - prill 2014, në shumën totale prej 10.530 usd.

**Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.09.2023, konfirmon llogarinë e Besnik Bakiu, në të cilën janë kryer veprimet e mëposhtme:

- ✓ Transaksione tërheqje (çek bankar) kryer nga shtetasi Besnik Bakiu si individ, jo klient dhe konkretisht: për vitin 2016, shumën 246.500 lekë dhe 2.295 usd; për vitin 2017, dy tërheqje me vlerë secila 1.700 usd (gjithsej 3.400 usd); për vitin 2018, shumën 1.496 usd; për vitin 2020, shumën 4.420 usd (me përshkrimin ekspert); për vitin 2022, shumën 255 euro (me përshkrim lehtësim koordinimi).
- ✓ Kreditime të interesave bankare, gjithsej 2.525 usd, maturuar gjatë periudhës 2002 - 2007, për depozitën e çelur më datë 13.04.2001, me vlerë 20.000 usd.
- ✓ Kreditime të interesave bankare, 3.623 usd, maturuar gjatë periudhës 2007 - 2014, për depozitën e çelur më datë 19.04.2007, me vlerë 22.500 usd.

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Besnik Bakiu dhe pagat e kredituara gjatë periudhës mars 2011 - mars 2023, në vlerën totale rreth 14.167.000 lekë (në vlerë janë përfshirë transfertat e kryera gjatë viteve 2011 - 2013 nga subjekti Poeteka, gjithsej 162.000 lekë).

Gjithashtu, në llogarinë e përbashkët në emër të Ketit dhe Besnik Bakiu, në datë 27.07.2020 është transferuar shuma 170 euro nga subjekti "Poeteka", projekt për fushën e policimit.

**ABI Bank**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 15.08.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Bakiu ka patur një llogari depozite (usd) të cilën e ka mbyllur më datë 17.04.2019. Bashkëlidhur ndodhen lëvizjet bankare në të cilën evidentohet se Besnik Bakiu depoziton cash vlerën 9.000 usd, datë 29.10.2007. Shuma është investuar në depozitë bankare dhe është tërhequr cash më datë 02.05.2008, në vlerën 9.133 usd.

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Bakiu ka patur llogari rrjedhëse e cila ka shërbyer për kreditimin e interesave bankare të depozitës së çelur në vitin 2007.

Për periudhën 2008 - 2020, subjekti ka përfituar interesa në vlerën totale rreth 6.970 usd. Gjithashtu, evidentohet se në këtë llogari janë transferuar nga Qendra Rajonale për Ekspert, gjithsej 3.570 usd për vitin 2018, (kredituar 4.760 usd, kthyer mbrapsht qendrës në vitin 2019, vlera - 1.190 euro), 3.910 usd për vitin 2019; 3.310 usd për vitin 2020.

**Intituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Bakiu ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: maj 2012 - janar 2015 pranë Qendrës së Formimit Policor/Akademisë së Sigurisë; janar 2015 - mars 2023 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

Gjithashtu, konfirmohet se gjatë periudhës dhjetor 2014 - mars 2023, rezulton i deklaruar në listë pagesat e Qendrës Rajonale për Parandalimin e Krimit, me vlerë 0 lekë.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se burimi financiar i shumës së depozituar në ABI Bank kanë qenë kursimet familjare si dhe honorarët që ka përfituar nga OJF-të e ndryshme si dhe institucionet ndërkombëtare. Shumat e tërhequra u përdorën për hapjen e depozitës të bashkëshortes në Credins Bank në vitin 2012.

Gjithashtu subjekti sqaroi se për çdo punë të kryer është paguar cash, dhe për të vërtetuar pagesat i është drejtuar me email institucioneve përkatëse por nuk i kanë kthyer përgjigjur. Subjekti paraqiti tabelë përmbledhëse të të ardhurave të realizuara si lektor/studiues/ekspert OJF të ndryshme dhe partnerët ndërkombëtarë. Përveç sa deklaruar më lart, subjekti ka cituar gjithashtu të ardhura shtesë si:

- Ekspert/lektor në trajnimin që UNHCR ka zhvilluar me autoritetet e Policisë së Shtetit etj., gjatë periudhës 2002 - 2004. Shuma e të ardhurave 4.800 usd. Bashkëlidhur, certifikatë mirënjohje për këtë kontribut e firmosur nga M. Hoffmann dhe L. Salzmänn.
- Ekspert/lektor në projektin pre-screening të zhvilluar nga IOM, Osce, Unhcr për trajnimin e oficerëve të nivelit të lartë e të mesëm të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Periudha shtator 2004 - shkurt 2005. Shuma e të ardhurave 2.800 usd. Bashkëlidhur, certifikatë mirënjohje për këtë kontribut, lëshuar nga IOM, Osce, Unhcr.
- Ekspert/konsulent në projektin Carpo 2002/2003, “Për zhvillimin e rehabilitimit të funksionimit të sistemit të policimit dhe forcimit të luftës kundër aktiviteteve kriminale”. Periudha 2002 - 2003. Shuma e të ardhurave 2.000 euro. Bashkëlidhur, fotokopje të kopertinave të manualeve.
- Koordinator dhe ekspert në projektin “Prania dhe roli i grave në polici”, organizuar nga QRPK, financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, gjatë viteve 2011 - 2012. Shuma e të ardhurave 3.600 usd. Bashkëlidhur, lëvizjet e llogarisë për pagesën e tatimit në burim 10% të QRPK për honorarin e Besnik Bakiu.
- Koordinator dhe lektor/ekspert në projektin “Prania dhe roli i grave në polici”, organizuar nga QRPK, financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, gjatë viteve 2012 - 2013. Shuma e të ardhurave 4.500 usd. Bashkëlidhur, lëvizjet e llogarisë për pagesën e tatimit në burim 10% të QRPK për honorarin e Besnik Bakiu.
- Koordinator dhe lektor/ ekspert në projektin “Prania dhe roli i grave në polici”, organizuar nga QRPK, financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, gjatë periudhës 2014. Shuma e të ardhurave 1.080 usd. Bashkëlidhur, lëvizjet e llogarisë për pagesën e tatimit në burim 10% të QRPK për honorarin e Besnik Bakiu.
- Bashkautor i manualit “Lidershipi në Policinë e Shtetit”, financuar nga Akademia e Zbatimit të Ligjit në Hagë, Holandë. Shuma e të ardhurave 1.500 euro. Bashkëlidhur, fotokopje e kopertinës së materialit.

Me postën elektronike të datës 21.02.2024, subjekti sqaroi se për periudhën nga viti 1991 - 1993 nuk disponon të dhënat e pagave të tij nga institucioni i Policisë së Shtetit, por disponon CV e tij, nxjerrë nga sistemi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Për periudhën nga viti 1993 deri në nëntor 1997, disponon vërtetim për të ardhurat e përfituara, lëshuar nga Njësia e Sigurisë dhe Ceremonialit të Policisë së Shtetit.

**Paraqiti:** Vërtetim nga Njësia e Sigurisë dhe Ceremonialit, për të ardhurat e përfituara nga Besnik Bakiu gjatë periudhës 15.08.1993 - 01.12.1997, në shumën totale neto prej 641.000 lekë; Curriculum Vitae, Besnik Bakiu.


### **Konkluzion:**



- ✓ *Të ardhurat e subjektit nga paga dhe shpërblimet, për periudhën gusht 1993 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 20.876.000 lekë.*
- ✓ *Të ardhurat e subjektit nga kontratat e shërbimeve, për periudhën 2011 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 7.200.000 lekë, për të cilat janë kryer pagesat tatimore në organet kompetente.*
- ✓ *Të ardhurat e subjektit nga interesat bankare, për periudhën 2008 - 2020, konfirmohen në vlerën totale rreth 1.426.000 lekë.*
- ✓ *Depozita pranë ABI Bank, çelur më datë 29.10.2007, me vlerë 9.000 usd, i përket periudhës përpara vitit 2008, dhe për këtë arsye aplikohet neni 32, pika 1.1, i Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

## **Deklarimi i shpenzimeve të subjektit të vlerësimit.**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, d, dh, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron shpenzimet e vitit të fundit për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha pagesat periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të tij ose të personave të lidhur; udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen, shpenzimet e përballuara; arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, në momentin e deklarimit apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve.

 Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, subjekti deklaron:

1. Shpenzime për ujë 30.000 lekë, energji elektrike 84.000 lekë, telefoni fiks dhe internet 15.000 lekë, shërbim celular 30.000 lekë (unë, bashkëshortja, djali dhe vajza). Shuma 159.000 lekë.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Librezë energjie elektrike në emër të Besnik Bakiu, kontratë nr. 56282. Shuma e paguar për vitin 2022, në vlerën rreth 70.000 lekë.
- Librezë UK në emër të Besnik Bakiu, kontratë nr. 062574. Shuma e paguar për vitin 2022, në vlerën rreth 31.000 lekë.

### **Procedura e vlerësimit:**

**FSHU**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.08.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Besnik Bakiu figurojnë të regjistruara 2 kontrata furnizimi me energji elektrike, ne instancat Tiranë dhe Korçë.

**Ujësjellës - Kanalizime Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\*, nuk konfirmon kontrata për shërbime ujësjellës kanalizime në Tiranë, regjistruar në emër të shtetasit Besnik Bakiu dhe personave të lidhur me të.

**14 Shogëritë Rajonale të Ujësjellës – Kanalizime**, me shkresat nr. \*\*\* prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Vodafone Albania sh.a.**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 12.01.2024, konfirmon se në emër të shtetasit Besnik Baku, figuron një numër aktiv; nr...797, datë aktivizimi 03.09.2019, shpenzimi i të cilës gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022 është në vlerën totale prej 100 lekë.

Shtetasit Besnik Baku (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë), i korrespondon një numër telefoni, 069....564, aktivizuar prej datës 25.06.2010. Vlera e shpenzuar për vitin 2022, gjithsej 7.800 lekë.

Shtetasit Krist Baku, i korrespondon një numër telefoni, 069....495, aktivizuar prej datës 18.12.2011. Vlera e shpenzuar për vitin 2022, gjithsej 21.400 lekë.

Shtetases Ketu Baku, i korrespondon një numër telefoni, 069....737, aktivizuar prej datës 14.09.2017. Nuk ka kryer pagesa për vitin 2022.

Shtetases Etleva Baku, nuk i korrespondon asnjë numër telefoni të kësaj shoqërie.

**One Albania sh.a.**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 11.10.2023, konfirmon se në emër të shtetases Etleva Baku, figuron një numër telefoni, aktivizuar në datë 10.01.2023.

**Albania Satellite Communications shpk.**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Abissnet sh.a.**, me shkresën nr. V-prot., datë 04.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Digicom sh.a.**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se shtetasi Krist Baku ka lidhur kontratë me shoqërinë nr. DG-16-\*\*\*-R, datë 20.10.2016. Për periudhën janar - prill, vlera e faturës ishte në shumën 2.190 lekë, ndërsa për periudhën maj - dhjetor, fatura mujore ka qenë në vlerën 1.590 lekë (përlllogaritur gjithsej 21.500 lekë).

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se arsyeja e mos konfirmimit të kontratës nga ujësjellësi ka ndodhur për shkak se gjatë regjistrimit është vendosur një shkronjë e mbiemrit të tij gabim. Ndërsa konfirmon se nuk ka lidhje me kontratën e konfirmuar nga FSHU Korçë, pasi përveç sa deklaruar, nuk disponon asnjë pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi të tij.

### **Konkluzion:**

- *Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefon, internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 152.000 lekë.*

🚩 Në mbështetje të nenit 33, pika 1/d, subjekti deklaron:

1. Shpenzimet jashtë shtetit kanë qenë zyrtare, me përjashtim të një vizite 3 ditore për martesën e mbesës time në Itali. Shuma 500 euro.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

**Raporti i hyrje - daljeve nga territori shqiptar për shtetasin Besnik Bakiu, ku evidentohen lëvizjet:**

- ✓ Dalje më datë 10.09.2021, hyrje më datë 13.09.2021.
- ✓ Dalje më datë 10.11.2021, hyrje më datë 12.11.2021.
- ✓ Dalje më datë 19.10.2022, hyrje më datë 21.10.2022.
- ✓ Hyrje më datë 24.11.2022.

**Raporti i hyrje - daljeve nga territori shqiptar për shtetasen Etleva Bakiu, ku evidentohen lëvizjet:**

- ✓ Dalje më datë 10.09.2021, hyrje më datë 13.09.2021.

**Raporti i hyrje - daljeve nga territori shqiptar për shtetasin Krist Bakiu, ku evidentohen lëvizjet:**

- ✓ Dalje më datë 21.05.2022, hyrje më datë 28.05.2022.

**Raporti i hyrje - daljeve nga territori shqiptar për shtetasen Keti Bakiu, ku evidentohen lëvizjet:**

- ✓ Hyrje më datë 20.12.2019, dalje më datë 05.01.2020.
- ✓ Hyrje më datë 05.07.2020, dalje më datë 26.07.2020.
- ✓ Hyrje më datë 09.09.2020, dalje më datë 27.09.2020.
- ✓ Hyrje më datë 04.01.2021, dalje më datë 26.02.2021.
- ✓ Hyrje më datë 01.09.2021, dalje më datë 03.10.2021.
- ✓ Hyrje më datë 15.12.2021, dalje më datë 06.01.2022.
- ✓ Hyrje më datë 13.02.2022, dalje më datë 27.02.2022.
- ✓ Hyrje më datë 27.03.2022, dalje më datë 11.05.2022.
- ✓ Hyrje më datë 24.06.2022, dalje më datë 14.07.2022.
- ✓ Hyrje më datë 07.09.2022, dalje më datë 06.10.2022.

Me inventarin e datës 29.01.2024, subjekti paraqiti raportin e hyrje - daljeve përgjatë viteve 2004 - 2024. Sqaroi se udhëtimet e kryera prej tij janë bërë për qëllime shërbimi, dhe private janë vetëm ato te kryera me bashkëshorten e tij, ku konkretisht specifikon 5 udhëtime të kryera në Ohër, Hungari, Itali dhe Belgjikë gjatë viteve 2015 - 2023, me vlerë totale të shpenzuar 500 euro. (referuar periudhës së kontrollit, rezulton vetëm 1 udhëtim i kryer gjatë viteve 2020 - 2022).

Udhëtimet e kryera nga Krist Bakiu, në total 7, gjatë periudhës 2007 - nëntor 2023, kanë koston vetëm të biletave të udhëtimit prej 450 euro, pasi akomodimi është mbuluar nga organizatorët e aktiviteteve ku ka qenë i ftuar, (referuar periudhës së kontrollit, rezulton vetëm një udhëtim i kryer gjatë viteve 2020 - 2022).

Udhëtimet e kryera nga Keti Bakiu, në total 25, gjatë periudhës 2014 - tetor 2023, kanë koston vetëm të biletave të udhëtimit prej 1.600 euro, (referuar periudhës së kontrollit, rezultojnë 10 udhëtime të kryera gjatë viteve 2020 - 2022).

Me procesverbalin e datës 28.02.2024, subjekti sqaroi se udhëtimi i vetëm i kryer nga ai dhe bashkëshortja ka patur si destinacion Italinë, me qëndrim në një apartament me qira ditore, paguar nga mbesa pasi shkuan për pagëzimin e fëmijës së saj. Udhëtimet e vazhës janë bërë vetëm me destinacion Tiranë - Belgjikë, për vajtje ardhjet universitet - shtëpi.


Udhëtimi i djalit ka patur si destinacion Vjenën, shpenzimet në vlerën e deklaruar. Qëndrimi i tij është paguar nga organizatorët e forumit të Davosit, të cilët e kishin ftuar.

Me postën elektronike të datës 29.01.2024, subjekti sqaroi periudhat e mëposhtme të udhëtimeve të punës te kryera prej tij:

- a) Periudha 10.11.2021 - 12.11.2021, ka udhëtuar për në Shkup, Maqedoni, në kuadër të një vizite studimore të grupit të punës që ishte ngritur për hartimin e planit të veprimit për ngritjen e sistemit të mësimdhënies online. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit u mbuluan nga Prezenca e OSBE-së në Tiranë. (Bashkëlidhur faksimilet e komunikimeve me email).
- b) Periudha 19.10.2022 - 21.10.2022, ka udhëtuar për në Budva - Mal të Zi, në kuadër të projektit të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Shqipëri” (JUFREX II). Të gjitha shpenzimet e udhëtimit u mbuluan nga Këshilli i Evropës. (Bashkëlidhur faksimilet e komunikimeve me email).
- c) Periudha 22.11.2022 - 24.11.2022, ka udhëtuar për në Romë Itali, për takime zyrtare në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për formimin dhe arsimin policor. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit u mbuluan nga buxheti i Policisë së Shtetit. (Bashkëlidhur faksimilet e urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit).

### **Konkluzion:**

- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje - daljeve nga Republika e Shqipërisë gjatë periudhës 2020 – 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.*
- *Shpenzimet e deklaruar për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar, deklarohen në total rreth 291.000 lekë.*

 Në mbështetje të nenit 33, pika 1/dh, subjekti deklaron:

1. Shpenzime për arsimimin e Keti Bakiu, në Universitetin Evropian të Tiranës. Shuma 1.875 euro.
  2. Shpenzime për arsimimin e Keti Bakiu, në Universitetin e Levenit, Belgjikë. Shuma 40.000 euro. **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Mandat arkëtimi datë 21.10.2016 nga Keti Bakiu pranë Universitetit Evropian të Tiranës, shuma 1.875 euro (sipas shënimeve, vlera përmban tarifën për të treja vitet akademike).

### **Procedura e vlerësimit:**

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari të përbashkët në emër të Keti dhe Besnik Bakiu, në të cilën rezultojnë transaksionet financiare në vijim:

- Transferim/kreditim nga Erasmus ICM, në datë 23.02.2018, vlera 2.818 euro dhe datë 01.08.2018, vlera 1.185 euro.
- Depozitim cash nga Besnik Bakiu, datë 30.05.2019, në shumën 9.600 euro, transferuar/debituar në vlerën 9.200 euro, me përshkrim “Student accounting and mobility”.
- Depozitim cash nga Besnik Bakiu, datë 13.09.2019, në shumën 1.520 euro, me përshkrim “Depo. në llog. Joint”.
- Depozitim cash nga Besnik Bakiu, datë 26.09.2019, në shumën 1.025 euro, me përshkrim “Depo. në llog. Joint”.
- Depozitim cash nga Besnik Bakiu, datë 08.09.2020, në shumën 8.500 euro, transferuar/debituar në vlerën 8.600 euro, me përshkrim “Student accounting and mobility”.
- Depozitim cash nga Besnik Bakiu, datë 28.09.2020, në shumën 1.000 euro, me përshkrim “Depo. Në llog. Joint”.
- Në datë 23.07.2021, Keti Bakiu depoziton 5.000 euro dhe Besnik Bakiu në datë 06.08.2021, shumën 4.000 euro. Në datë 06.08.2021, transferon shumën 8.600 euro në favor të “KU Leuven”.
- Në datë 11.03.2022, Besnik Bakiu depoziton 3.000 euro dhe në datë 12.08.2022, shumën 6.800 euro.
- Në datë 12.08.2022, transferon shumën 9.700 euro, në favor të “KU Leuven”.
- Depozitim cash nga Besnik Bakiu, datë 29.09.2022, në shumën 1.100 euro, me përshkrim “Depo. në llog. Joint”.
- Në datë 24.02.2023, Besnik Bakiu depoziton 3.000 euro dhe në datë 03.08.2023, shumën 8.000 euro. Në datë 03.08.2023, transferon shumën 10.300 euro, në favor të “KU Leuven”.

**Institucioni bankar** konfirmon në emër të shtetasit Besnik Bakiu dhe dy kreditë e përfituara prej tij, në datë 21.02.2020, me vlerë 500.000 lekë (shlyer në shkurt 2023) dhe në datë 05.04.2016, me vlerë 700.000 lekë (shlyer në 06.03.2019, depozitim cash 310.000 lekë për mbyllje kredie para afatit). Mbyllur kredia më datë 06.03.2019 për vlerën e mbetur prej 330.952 lekë me përshkrimin “shlyerje totale kredie”.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se shuma prej 1.875 euro është vlera totale për periudhën e studimeve universitare të vajzës së tij, e cila është e pasqyruar edhe në mandat pagesën e UET. Aktualisht, vajza e tij është studente në Universitetin KU Leuven, Belgjikë, me adresë banimi: Geldenaaksevest 4 Leuven, Belgjikë. Transaksionet financiare ndër vite janë pagesat që ai i dërgon KU Leuven Belgjikë për vajzën. Në bazë të rregullave të Universitetit KU Leuven, dërgesa e pagesës bëhet në fillim të vitit shkollor, ku përfshihet tarifa e regjistrimit dhe shpenzimet e jetesës. Çdo fillim muaji, KU Leuven, Belgjikë, nga shuma e dërguar prej tij, i transferon vajzës shumën e paracaktuar prej tyre, për përballimin e shpenzimeve të jetesës për muajin. Gjithashtu, në këtë llogari është depozituar edhe shuma me vlerë 750 euro/muaj + 820 euro shpenzime udhëtimi, për periudhën shkurt - korrik 2018, kur vajza kishte fituar bursën Erasmus për të bërë studime semestrale universitare në Budapest, Hungari.

Burimi i financimit të shpenzimeve universitare janë: një pjesë e shumës së tërhequr në 25.04.2014 nga llogaria dhe depozita bankare e tij pranë Intesa SanPaolo Bank me vlerë 20.000 usd hapur në vitin 2001; një pjesë e shumës së tërhequr nga depozita e tij në Credins Bank në vitin 2020 (22.500 usd); tërheqja e depozitës së Etleva Bakiu në vitin 2017 (përfitur nga depozita “Futura” e vajzës); kursime familjare; honorarë që ka përfitur nga OJF-të e ndryshme si dhe pjesë nga dy kreditë e marra.

Vajza, Keti Bakiu, ka qenë nxënëse në gjimnazin “Petro Nini Luarasi” dhe studimet universitare i kreu në Universitetin UET. Djali, Krist Bakiu, ka qenë student në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, ku përfundoi edhe studimet pas universitare. **Paraqiti:**

- Letër konfirmimi nga KU Leuven, Belgjikë, datë 01.04.2019, për Keti Bakiu, si studente në programin master psikologji për vitin akademik 2019 - 2020. Referuar udhëzimeve bashkëlidhur, pagesa për vitin akademik 2019 - 2020 është 938.8 euro.
- Faturë datë 21.09.2020 nga KU Leuven për Keti Bakiu, vlera 977 euro.
- Faturë datë 06.10.2021 nga KU Leuven për Keti Bakiu, vlera 986 euro.
- Marrëveshje për marrjen e dëshmisë së aftësisë paguese, lëshuar nga KU Leuven, Belgjikë, në të cilën përcaktohet se një shumë prej 8.500 euro tarifë administrative, duhet të bëhet në llogarinë bankare të Universitetit KU Leuven. Sapo KU Leuven të ketë marrë shumën e kërkuar, do lëshohet një certifikatë financiare, si dëshmi e aftësisë paguese për aplikimin e vizës dhe qëndrimit të ligjshëm. Universiteti, njofton, gjithashtu se studenti duhet të ketë një llogari bankare belge në të cilën një shumë prej 700 euro do të transferohet çdo muaj brenda 3 - 5 ditëve të para të punës nga 01.10.2020 - 30.09.2021 me qëllim vërtetimin ndaj autoriteteve belge të mundësive financiare të studentit.
- Marrëveshje për marrjen e dëshmisë së aftësisë paguese, lëshuar nga KU Leuven, Belgjikë, në të cilën përcaktohet se një shumë prej 9.700 euro tarifë administrative, duhet të bëhet në llogarinë bankare të Universitetit KU Leuven. Sapo KU Leuven të ketë marrë shumën e kërkuar, do lëshohet një certifikatë financiare, si dëshmi e aftësisë paguese për aplikimin e vizës dhe qëndrimit të ligjshëm. Universiteti, njofton gjithashtu se studenti duhet te ketë një llogari bankare belge në të cilën një shumë prej 800 euro do të transferohet çdo muaj brenda 3 - 5 ditëve të para të punës nga 01.10.2022 - 30.09.2023 me qëllim vërtetimin ndaj autoriteteve belge të mundësive financiare të studentit.
- Certifikatë financiare e lëshuar nga KU Leuven në datë 17.08.2023, për konfirmimin e pagesës prej 10.300 euro nga Keti Bakiu, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të jetesës gjatë studimeve në vitin akademik 2023 - 2024. Gjatë periudhës 01.10.2023 - 30.09.2024, një shumë prej 820 euro do të transferohet çdo muaj në llogarinë rrjedhëse të personit në Belgjikë.
- Letër pranimi datë 19.01.2018 nga Eotvos Lorand University, për Keti Bakiu, e cila është pranuar si pjesë e programit Erasmus Plus për semestrin e pranverës të vitit akademik 2017 - 2018, shkurt - korrik 2018. Studenti do të përfitojë shumën 750 euro/muaj si grant plus 820 euro për shpenzime udhëtimi.
- Lëvizjet bankare të vajzës Keti Bakiu në Belgjikë gjatë periudhës 28.10.2019 - 16.03.2023, në të cilën evidentohen transaksionet e kreditimeve mujore periodike, të kryera në favor të saj nga Katholieke Universiteit Leuven. Gjendje në llogari datë 06.03.2023, në vlerën 617.99 euro.

Lidhur me vlerat respektive të përdorura si burim për shpenzimet arsimore, Trupa e Vlerësimit ka analizuar depozitat bankare të përmendura nga subjekti i vlerësimit, si dhe ka vlerësuar mundësinë për kursim sipas periudhave që janë kryer shpenzimet, e konkretisht:

- Depozita bankare pranë Intesa SanPaolo Bank me vlerë 20.000 usd çelur në vitin 2001, tërhequr shuma 26.123 usd në vitin 2014.
- Depozita në Credins Bank me vlerë 22.500 usd çelur në vitin 2007, tërhequr shuma në datë 27.04.2020, në vlerën 24.498 usd.
- Depozitë e Etleva Bakiu çelur në vitin 2015 në vlerën 11.880 usd, tërhequr në vlerën 11.895 usd në vitin 2017. Depozita ka si burim depozitën e vajzës Keti Bakiu krijuar në vitin 2006 në

vlerën 10.000 usd, transferuar në llogari të Etleva Bakiu në vitin 2015, përfshirë interesat. (Trajtuar më poshtë).

Sa më sipër subjekti i vlerësimit, ka depozituar pranë institucioneve bankare përgjatë periudhës 2001 – 2007, vlerën 52.500 usd, të cilat janë tërhequr përgjatë periudhës 2014 – 2020, në vlerën 62.516 usd përfshirë interesat e fituara, (10.016 usd).

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursime me qëllim pagesën e detyrimeve arsimore, ka kryer analizën financiare përkatëse (Aneksi 1).

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinimin e subjektit, si dhe dokumentacionin e paraqitur, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

- *Transfertat e kryera nga subjekti në favor të Universitetit KU Leuven, Belgjikë, përmbajnë gjithashtu edhe shpenzimet e jetesës, të cilat i transferohen periodikisht vajzës në llogarinë e saj bankare në Belgjikë.*
- *Lidhur me burimin financiar të përdorur për mbulimin e shpenzimeve të universitetit, subjekti deklaroi pakësimin e depozitave bankare të krijuara përpara vitit 2008, kursime familjare, honorarë që ka përfituar nga OJF-të e ndryshme si dhe pjesë nga dy kreditë e marra pranë institucionit bankar.*
- *Depozitat bankare, të cilat janë përdorur si burim i pjesshëm i shpenzimeve universitare, janë krijuar përpara vitit 2008, dhe për këtë arsye është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*
- *Subjekti i vlerësimit, ka tërhequr nga depozitat bankare gjatë periudhës 2014 – 2020, vlerën rreth 62.516 usd përfshirë interesat e fituara (10.016 usd), me qëllim përdorimin e pjesshëm për shpenzime universitare.*
- *Shpenzimet për arsimimin dhe jetesën e vajzës gjatë periudhës 2016 - mars 2023, rezultojnë në total rreth 4.765.000 lekë.*
- *Për periudhën e studimeve semestrale në Hungari në vitin 2018, shpenzimet janë mbuluar nga bursa Erasmus Plus, në shumën e dokumentuar rreth 4.000 euro.*
- *Nga analiza financiare, rezulton se subjekti i vlerësimit, gjatë periudhës 2019 – 2023, ka pasur të ardhura të mjaftueshme me qëllim pagesën e detyrimeve arsimore dhe bankare.*

## **DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – ETLEVA BAKIU**

### **Deklarimi i pasurisë**

Bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, Znj. Etleva Bakiu, ka deklaruar pasuritë si më poshtë:

1. Apartament me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, blerë në shumën 26, 911 lekë, më datë 12.11.1993 nga privatizimi. Regjistruar më datë 19.12.2011, me nr. pasurie \*\*\*. Pjesë takuese 50%. Burimi i krijimit: Kursime. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 26.09.2001, të pasurisë apartament me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. \*\*\*, Zk. \*\*\*, në pronësi të Veli Toto, Fatmira Toto, Besnik Baku, Etleva Baku, ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Bashkëlidhur, kartela e pasurisë së paluajtshme, planimetria dhe plan vendosja e apartamentit.

### **Procedura e vlerësimit:**

**ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2023, konfirmon pasurinë apartament me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, Zk. \*\*\*, në emër të Etleva Baku. Bashkëlidhur ndodhet kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, regjistruar në datë 03.06.2022, me dëshmi trashëgimie, zotëruese e  $\frac{3}{4}$  pjesë dhe diferenca  $\frac{1}{4}$  pjesë në emër të L. M. Në datë 23.05.2013, pasuria regjistrohet e plotë 1/1 pjesë, në emër të Etleva Baku, nëpërmjet kontratë dhurimit.

### **Bashkëlidhur:**

- Certifikatë regjistrimi dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme apartament, me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, regjistruar me pjesë takuese  $\frac{3}{4}$  në emër të Etleva Baku, me nr. \*\*\*, ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Nd. \*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë. Akti i përfitimit të pronësisë: me dëshmi trashëgimie datë 22.05.2022.
- Certifikatë regjistrimi dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme apartament, me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, regjistruar me pjesë takuese  $\frac{1}{4}$  në emër të L. M, me nr. \*\*\*, ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Nd. \*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë. Akti i përfitimit të pronësisë: me dëshmi trashëgimie datë 22.05.2022.
- Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.05.2023, nënshkruar ndërmjet palës dhuruese L. M dhe palës pranuese të dhurimit Etleva Baku, të pasurisë së paluajtshme apartament, ndodhur në ndërtesën \*\*\*, regjistruar me nr. \*\*\*, me sip. të përgjithshme 107, 7 m<sup>2</sup>. Origjina e përfitimit të pronësisë për dhuruesen L. M është nga trashëgimia e prindërve të saj Veli Toto dhe Fatmira Toto. Objekti i kësaj kontrate është dhurimi i  $\frac{1}{4}$  pjesë i kësaj pasurie të paluajtshme, nga dhuruesja L. M tek pranuesja e dhurimit Etleva Baku, e cila është gjithashtu bashkëpronare në këtë pasuri me  $\frac{3}{4}$  pjesë.
- Certifikatë regjistrimi dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të Etleva Baku, me nr. \*\*\*, ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, Nd. \*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë. Akti i përfitimit të pronësisë: me kontratë dhurimi datë 23.05.2023.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se ky apartament është blerë në vitin 1993 nga privatizimi, me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.11.1993, ku bashkëpronarë ishin 4 persona, të ndjerët, prindërit e bashkëshortes, bashkëshortja dhe vetë subjekti, në  $\frac{1}{4}$  pjesë takuese. Në vitin 2001, për arsye familjare, subjekti deklaroi se i shiti formalisht bashkëshortes pjesën e tij për vlerën 200.000 lekë, duke u bërë kështu pronar me  $\frac{1}{2}$  pjesë të apartamentit. Pas ndarjes nga jeta të prindërve të bashkëshortes, u çel trashëgimia ligjore nr. 867 rep., nr. 359 kol., datë 22.05.2022, ku bashkëshortja u bë pronare me  $\frac{3}{4}$  pjesë, ndërsa  $\frac{1}{4}$  pjesë i takonte motrës së saj, L. M. Më pas, motra i dhuron pjesën e saj takuese bashkëshortes, duke u bërë kështu pronare e vetme e kësaj pasurie. Apartamentit nuk i është bërë mobilim por ka ngelur me mobilimin që kishin bërë prindërit e ndjerë të bashkëshortes. **Paraqiti:**

- Kontratë shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.11.1993, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Ndërmarrja Komunale Banesa dhe palës blerëse Veli Toto, Fatmira Toto, Besnik Baku, Etleva



Bakiu, të një apartamenti të ndodhur në rr. “\*\*\*\*” me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 26.911 lekë.

- Certifikatë regjistrimi për vërtetim pronësie të pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, regjistruar në emër të Veli Toto, Fatmira Toto, Besnik Bakiu, Etleva Bakiu, me nr. \*\*\*, ndodhur ne rr. “\*\*\*\*”, Nd. \*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë. Data e lëshimit të certifikatës 26.09.2001.
- Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.11.2001, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Besnik Bakiu dhe palës blerëse Etleva Bakiu, të ¼ pjesë takuese mbi apartamentin me sip. 107, 7 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. \*\*\*, ndodhur ne rr. “\*\*\*\*”, Nd. \*\*\*, Tiranë. Vlera e shitjes 200.000 lekë, është shlyer totalisht nga blerësi tek shitësi.
- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.05.2022, të trashëgimlënës Fatmira Toto, duke përcaktuar si trashëgimtare ligjore të radhës së parë fëmijët Etleva Bakiu dhe L. M, me ½ pjesë takuese.
- Kontratë dhurimi nr. 948 rep., nr. 422 kol., datë 23.05.2023, nënshkruar ndërmjet palës dhuruese L. M dhe palës pranuese të dhurimit Etleva Bakiu, të pasurisë së paluajtshme apartament, ndodhur në ndërtesën \*\*\*, regjistruar me nr. \*\*\*, me sip. të përgjithshme 107, 7 m<sup>2</sup>. Origjina e përfitimit të pronësisë për dhuruesen L. M është nga trashëgimia e prindërve të saj Veli Toto dhe Fatmira Toto. Objekti i kësaj kontrate është dhurimi i ¼ pjesë i kësaj pasurie të paluajtshme, nga dhuruesja L. M tek pranuesja e dhurimit Etleva Bakiu, e cila është gjithashtu bashkëpronare në këtë pasuri me ¾ pjesë.

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se:

- *Apartamenti me sip. 107, 7 m<sup>2</sup> është përfitur nga privatizimi ne vitin 1993, fillimisht në emër të bashkëshortes, prindërve të saj dhe subjektit (pjesë takuese ¼ secili). Më pas, me qëllim heqjen dorë nga pjesa e tij takuese, subjekti i shet pjesën e vet bashkëshortes, duke e bërë kështu zotëruese të ½ pjesë të apartamentit. Në vitin 2023, pas ndarjes nga jeta të prindërve të bashkëshortes, motra e bashkëshortes, i dhuron ¼ e pjesës së saj takuese mbi këtë apartament.*
  - *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.*
  - *Nuk deklarohen shpenzime mobilimi për apartamentin e mësipërm nga subjekti dhe bashkëshortja.*
  - *Pasuria e paluajtshme është krijuar përpara vitit 2008, dhe për të është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*
2. Gjendje cash. Vlera 10.000 euro. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: Kursime familjare ndër vite, dhuratë nga prindërit. **Trajtuar më sipër.**
  3. Llogari page në BKT, me gjendje në datë 17.02.2023, në vlerën 30.000 lekë. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: Kursimet nga paga.

### **Procedura e vlerësimit:**

**BKT**, me shkresën nr. 61/3 prot., datë 22.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasës Etleva Bakiu, me gjendje në datë 10.03.2023, në vlerën 34.055 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.***

### **Deklarimi i të ardhurave nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit**

- Të ardhura nga punësimi në shtëpinë e oficerëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për periudhën 01.01.1987 - 31.12.1991. Shuma e të ardhurave 39.000 lekë.
- Të ardhura nga punësimi në shtëpinë e oficerëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për periudhën 01.01.1991 - 30.04.2015. Shuma e të ardhurave 2.590.000 lekë. Dokumentacion për këtë periudhë nuk u gjet, me gjithë kërkesat e përsëritura që paraqita pranë Drejtorisë së Financave dhe Arkivit të Ministrisë së Brendshme.
- Pagesë papunësie, për periudhën 01.05.2005 - 31.03.2006. Shuma e të ardhurave 55.000 lekë.
- Të ardhura nga paga neto në kompaninë e sigurimeve “Interalbania”. Shuma e të ardhurave 10.241.502 lekë.
- Dhuratë nga babai im Veli Toto, 13.04.2008. Shuma e të ardhurave 20.000 usd.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim nr. 639 prot., datë 05.04.2018, nga Sigma Interalbani, për të ardhurat e realizuara nga shtetasja Etleva Baku, gjatë periudhës 01.09.2008 - mars 2018, në shumën totale neto rreth 7.986.000 lekë.
- Marrëveshje për depozitë me afat, nënshkruar në datë 13.04.2007 nga Veli Toto dhe Etleva Baku pranë Raiffeisen Bank. Vlera 20.000 usd. Afat maturimi 1 vit.
- Lëvizjet e llogarisë pranë Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit Veli Toto gjatë periudhës 02.09.2005 - 22.04.2009, në të cilën evidentohet tërheqja e shumës 21.291 usd, në datë 22.04.2009, me përshkrimin “Të dhuruara”.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 10.08.2023, konfirmon interesat neto në vlerën 649 usd, përfituar nga shtetasja Etleva Baku si rezultat i investimit të kryer në depozitën datë 16.03.2012, me vlerë 15.000 usd. Referuar lëvizjeve bankare bashkëlidhur shkresës, evidentohet se bashkëshortja Etleva Baku, në datë 16.03.2012 ka depozituar cash shumën 15.000 usd dhe e ka transferuar në depozitë me afat. Shuma është tërhequr cash nga llogaria në datë 18.03.2014, në vlerën 15.649 usd.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se burimi financiar i depozitës së bashkëshortes në Raiffeisen Bank, është dhurimi i depozitës së përbashkët me afat çelur më datë 13.04.2007 që i kishte hapur i ati i saj.

Me inventarin e datës 28.02.2024, subjekti sqaroi se babai i bashkëshortes, i ndjeri Veli Ibrahim Toto, në kushtet e shqetësimit për papunësinë e familjes së vajzës së tij, në datë 13.04.2007, me kursimet e tij hap pranë Bankës Raiffeisen një depozitë të përbashkët me vajzën e tij, Etleva Veli Baku, me afat me vlerë 20.000 usd. Më datë 22.04.2009, këtë vlerë financiare i'a ka dhuruar vajzës (bashkëshortes së subjektit). Kjo vërtetohet nga fakti se gjithë shuma në vlerën 21.291 usd është tërhequr nga kjo llogari nga bashkëshortja Etleva Veli Baku.

Trupa e Vlerësimit ka verifikuar lëvizjet e llogarisë pranë Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit Veli Toto gjatë periudhës 02.09.2005 - 22.04.2009, në të cilën evidentohet tërheqja e shumës 21.291 usd, në datë 22.04.2009, me përshkrimin “Të dhuruara”.

**BKT**, me shkresën nr. 61/3 prot., datë 22.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasës Etleva Bakiu dhe pagat e kredituara gjatë periudhës 28.04.2016 - 06.03.2023, nga Sigma Interlbanian Vig, në vlerën totale rreth 6.140.000 lekë.

Gjithashtu, konfirmohen interesat neto për vitin 2016, vlera 970 usd; për vitin 2018, vlera 467 usd; për vitin 2020, vlera 356 usd, përfituar nga shtetasja Etleva Bakiu si rezultat i investimit të kryer në depozitën datë 21.03.2014, me vlerë 25.000 usd. Depozitë e tërhequr totalisht në datë 11.05.2020, në vlerën 25.000 usd.

**Me emailin e datës 18.04.2024**, subjektit i është kërkuar të japë sqarime lidhur me burimin e krijimit të vlerës prej 25.000 usd më datë 21.03.2014, si dhe destinacionin pas pakësimit të kësaj depozite.

Subjekti i vlerësimit është shprehur se burimi i të ardhurave lidhur me investimin e kryer kanë qenë të ardhurat nga kursimet familjare, pagesat si ekspert/lektorë pranë OJF-ve të ndryshme dhe institucionet ndërkombëtare, si dhe ndihmë nga prindërit e ndjerë të bashkëshortes së tij.

Kjo shumë është përdorur për të përballuar shpenzimet e shkollës për vajzën e tij Keti Bakiu në Belgjikë.

**Credins Bank**, me shkresën nr. 61/10 prot., datë 31.08.2023, konfirmon interesat neto në vlerën 647 usd, përfituar në datë 15.03.2014, nga shtetasja Etleva Bakiu, si rezultat i investimit të kryer në depozitën datë 16.03.2012, me vlerë 15.000 usd. Shtetasja Etleva Bakiu ka patur depozitë me afat 2 vjeçar, çelur më datë 16.03.2012, nëpërmjet depozitimit cash me vlerë 15.000 usd. Depozita është tërhequr cash më datë 18.03.2014, në vlerën 15.647 usd.

**Me procesverbalin e datës 29.01.2024**, subjekti sqaroi se depozita e bashkëshortes me vlerë 15.000 usd ka patur si burim të ardhurat 9.133 usd të tërhequra nga depozita e tij në ABI Bank si dhe diferenca nga kursimet familjare dhe interesat bankar. Shumat e tërhequra për mbylljen e depozitës u përdorën për të plotësuar çeljen e depozitës 25.000 usd, në BKT, të djalit Krist Bakiu, diferenca për nevoja familjare.

**Procredit Bank**, me shkresën nr. 61/7 prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasës Etleva Bakiu dhe pagat e kredituara gjatë periudhës 21.10.2008 - 01.04.2016, nga Sigma Interlbanian Vig, në vlerën totale rreth 5.127.000 lekë.

Shtetasja Etleva Bakiu ka patur llogari në euro, aktive gjatë periudhës 2010 - 2011. Evidentohet se në datë 01.02.2010, depoziton cash shumën 13.500 euro me përshkrimin “të ardhura personale”.

Në datë 03.02.2010, transferon shumën 13.465 euro në favor të M. S (transfertë ndërkombëtare), me përshkrimin “kthim borxhi”.

Gjithashtu në emër të Etleva Bakiu, rezulton e hapur llogari kursimi, më datë 05.12.2012, ku është depozituar cash fillimisht shuma prej 5.000 lekë. Gjendja e llogarisë në vitin 2012 rezulton në

vlerën 5.000 lekë, në vitin 2013 rezulton në vlerën 60.381 lekë, në vitin 2014 rezulton në vlerën 161.889 lekë, në vitin 2015 rezulton në vlerën 272.474 lekë dhe deri më datë 14.04.2016 rezulton në vlerën 314.121 lekë, të cilat janë tërhequr cash.

Me postën elektronike të datës 29.01.2024, lidhur me transaksionin prej 13.500 euro, subjekti sqaroi se kjo depozitë dhe transfertë është bërë për llogari të burrit të motrës së bashkëshortes Q. M, i cili në atë kohë ishte deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Sipas vërtetimit të Njësisë Bashkiake Ulëz, Bashkia Burrel dhe deklaratës personale të shtetasit Q. M, kjo transfertë është kryer për të shlyer një borxh personal dhe afat të shkurtër mikut të tij M. S, e cila është përdorur nga ai për të ndihmuar duke i ndërtuar një shtëpi banimi një familje të varfër në zonën e tij elektorale. **Paraqiti:**

- Deklaratë datë 24.02.2024 e shtetasit Q. M, i cili konfirmon se në vitin 2009 i ka marrë shtetasit M. S (i punësuar në Nordik Consulting Group, Kopengahen, Danimarkë), shumën 100.000 korona daneze ose 12.106 euro, vlerë kjo e siguruar në tetor 2009. Qëllimi i borxhit ka qenë për të përballuar fillimin e punimeve për ndërtimin e një shtëpie banimi për një familje të varfër në Bushkash të Komunës Ulëz. Në atë kohë, deklaroi se ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë në këtë zonë. Me kursimet e tij personale dhe të familjarëve të tij, shuma e mësipërme është siguruar në muajin shkurt 2010, duke ja kthyer mbrapsht shtetasit M. S, me anë të një transferte bankare. Transferta është kryer nga llogaria personale e kumatës së tij Etleva Bakiu, sepse ajo dispononte një llogari në Procredit Bank, e cila siguronte kalimin me kostot më të ulëta të transfertës, për shkak të lidhjeve të drejtpërdrejta me bankat korrespondente daneze.
- Vërtetim datë 25.01.2024 nga Njësia Administrative Ulëz, Bashkia Mat, në të cilën vërtetohet se në vitet 2010 - 2012 është ndërtuar shtëpia e shtetasit D. Ll, nga themelet, me kontributin financiar të ish deputetit Q. M.

**Me emailin e datës 18.04.2024**, subjektit të vlerësimit, i është kërkuar sqarim nëse vlera prej 13.500 euro janë të ardhura personale sipas institucionit bankar.

**Me emailin e datës 19.04.2024**, subjekti i vlerësimit i ka qëndruar deklaratës së dorëzuar gjatë hetimit administrativ.

**Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.09.2023, konfirmon se shtetasja Etleva Bakiu, ka patur një llogari rrjedhëse (usd) aktive gjatë viteve 2015 – 2017. Llogaria është çelur nëpërmjet transferimit/kreditimit të shumës 11.880 usd, në datë 18.12.2015 nga Keti Bakiu “kalim fondi”. Në vitin 2017, vlera 11.895 usd është tërhequr totalisht cash, nga të cilat, 6.850 usd me përshkrimin “shpenzime”, ndërsa diferenca 5.045 usd “për mbyllje llogarie”.

Nga verifikimi rezulton se shtetasja Keti Bakiu, ka patur llogari të çelur në datë 15.12.2006, nëpërmjet depozitimit cash nga Etleva Bakiu të shumës 10.000 usd, vlerë e cila ka qenë gjendje dhe ka maturuar interesa bankar, deri në datën 17.12.2015 kur është transferuar/debituar në favor të Etleva Bakiu, në vlerën 11.881 usd. (Interesa bankar 1.800 usd).

Me postën elektronike të datës 29.01.2024, lidhur me transaksionet në Intesa Sanpaolo Bank, subjekti sqaroi se llogaria e bashkëshortes ka patur si burim transferimin/kreditimin e shumës 11.880 usd të depozitës Futura qe kishte vajza (2006 - 2015), me vlerë 10.000 usd. Burimi financiar i kësaj të fundit janë të ardhurat nga kursimet familjare, pagesat si ekspert/lehtësues në institucionet

ndërkombëtare dhe OJF-të si dhe ndihma nga gjyshërit në vlerë 1.000 usd. Depozita kaloi në emër të bashkëshortes në vitin 2015 dhe më pas është tërhequr cash në vitin 2017. Tërheqja e depozitës në vitin 2017 është përdorur për të përballuar shpenzimet e shkollimit të vajzës në Belgjikë.

Trupa e Vlerësimit konstaton se vlera e kredituar në llogarinë e Etleva Bakiu prej 11.880 usd, ka si burim depozitën e Ketii Bakiu krijuar në vitin 2006 (përpara vitit 2008), dhe kursimet familjare.

**Instituti i Sigurimeve Shogërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se shtetasja Etleva Bakiu ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: janar 2012 - mars 2013 pranë Interbalkanian Vienna Insurance Group.

Me postën elektronike të datës 21.02.2024, subjekti sqaroi se babai i bashkëshortes Veli Ibrahim Toto, ka përfunduar studimet për mjekësi në Pragë të Republikës së Çekosllovakisë, në vitin 1955.

Pas përfundimit të studimeve ka punuar mjek i përgjithshëm në Kavajë, Ishullin e Sazanit, Tropojë dhe Tiranë. Në vitin 1960 u specializua si mjek urolog. Gjatë periudhës 1972 - 1991 ka kryer detyrën e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ushtarake (Spitali Ushtarak) dhe kryetar i Këshillit Shkencor të Institutit të Mjekësisë Ushtarake. Nga viti 1974 - 1991 ka qenë anëtar i Këshillit Shkencor të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tiranës dhe kryeredaktor i Buletinit Shkencor të Mjekësisë Ushtarake. Nga viti 1991 deri sa u nda nga jeta në vitin 2016 ka ushtruar profesionin si mjek urolog në profesion të lirë. Nëna e bashkëshortes Fatmira Mygjni Toto ka kryer detyrën e shefes së burimeve njerëzore në Institutin e Studimeve të Teknologjisë Minerale, në Tiranë. **Paraqiti:**

- Vërtetim nr. 888 prot., datë 02.02.2022 nga DRSSH Tiranë: Për vjetërsinë në punë, për efekt pensioni të Etleva Veli Toto, e cila rezulton e punësuar për periudhën 01.01.1987 - 30.04.2005, pranë Shtëpisë së Oficerave (Klubi i Ministrisë së Rendit Publik).
- Kontributet e paguara për të ardhurat (bruto) të realizuara gjatë periudhës tetor 1993 - prill 2005 pranë “Klubi i Ministrisë së Rendit Publik”, në total rreth 1.690.000 lekë.
- Rezultatet e verifikimit të dokumentacionit që disponohet nga DAQ Lundër për subjektin “Bar Restorant Belmondo”, për periudhën prill 2006, nuk figuron asnjë subjekt me këtë emërtim.
- Rezultatet e verifikimit të dokumentacionit që disponohet nga DAQ Lundër për subjektin “Drejtoria e Policisë Qarku Lezhë”, për periudhën prill 2006 - shtator 2006, nuk administrojnë listë pagesa + bordero.
- Rezultatet e verifikimit të dokumentacionit që disponohet për periudhën mars 2005 - maj 2006, në të cilën nuk administrohen listë pagesa për pagesë papunësie.
- Vërtetim nr. 1059 prot., datë 22.02.2022, nga Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për Etleva Toto, e cila gjatë periudhës 01. 05.2005 - 31.03.2006 ka përfituar pagesë papunësie, në vlerën totale rreth 48.000 lekë.

### **Konkluzion:**

- *Të ardhurat e bashkëshortes nga paga, për periudhën 1993 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 13.000.000 lekë.*
- *Të ardhurat e bashkëshortes nga interesat bankare, për periudhën 2016 - 2020, konfirmohen në vlerën totale rreth 3.089 usd, konvertuar rreth 332.000 lekë.*

- *Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me burimin e krijimit të vlerës prej 25.000 usd në BKT, më datë 21.03.2014, si dhe destinacionin pas pakësimit të kësaj depozite.*
- *Referuar analizës financiare, konstatohet se bashkëshortja e subjektit të vlerësimit ka pasur mundësi me qëllim kursimin e vlerës prej 25.000 usd, për hapjen e depozitës bankare pranë BKT në vitin 2014.*
- *Gjithashtu konstatohet se bashkëshortja e subjektit të vlerësimit ka pasur mundësi me qëllim kursimin e vlerës prej 5.867 usd, si burim të pjesshëm për krijimin e depozitës bankare pranë Credins Bank në vitin 2012.*
- *Vlera prej 9.133 usd, përdorur si burim i pjesshëm i krijimit të depozitës pranë Credins Bank, është krijuar përpara vitit 2008, dhe për këtë qëllim aplikohet neni 32, pika 1.1 e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*
- *Lidhur me vlerën prej 11.880 usd, kredituar në llogarinë e Etleva Bakiu pranë Intesa SanPaolo Bank, aplikohet neni 32, pika 1.1 e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*
- *Trupa e Vlerësimit ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e dorëzuar lidhur me vlerën e depozituar prej 13.500 euro pranë Procredit Bank.*
- *Vlera e dhuruar prej 21.291 usd, është krijuar në vitin 2007, dhe për këtë arsye aplikohet neni 32, pika 1.1 e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

## **DEKLARIMI I DJALIT – KRIST BAKIU**

### **Deklarimi i pasurisë**

1. Llogari rrjedhëse në Intesa Sanpaolo Bank, me gjendje në datë 17.02.2023, në vlerën 200.000 lekë. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: Kursime nga paga.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.09.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të shtetasit Krist Bakiu, me gjendje në datë 10.03.2023, në vlerën 0 lekë. Tërhequr totalisht shuma 200.000 lekë, në datë 19.01.2023 dhe 20.01.2023.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se *nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.*

*Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme.*

*Referuar analizës financiare, konkludohet se Krist Bakiu, ka pasur mundësi me qëllim kursimin e vlerës prej 200.000 lekë në janar 2023.*

2. Llogari rrjedhëse në BKT, me gjendje në datë 17.02.2023, në vlerën 400.000 lekë. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: Kursime nga paga.

### **Procedura e vlerësimit:**

**BKT**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon llogari page në emër të Krist Bakiu, me gjendje në datë 10.03.2023, vlerën 401.304 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.***

***Referuar analizës financiare, konkludohet se Krist Bakiu, ka pasur mundësi me qëllim kursimin e vlerës prej 400.000 lekë në mars 2023.***

3. Llogari rrjedhëse në BKT, me gjendje në datë 17.02.2023, në vlerën 20.000 usd. Pjesë takuese 100%. **Burimi i krijimit:** Kursime nga paga dhe dhuratë nga gjyshërit me kontratën për llogarinë e kursimeve “fonde për të ardhmen e fëmijës” për Krist Bakiu dhe motrën time Keti Bakiu, pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, datë 15.12.2006. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë depozite me afat, nënshkruar në datë 01.12.2021, ndërmjet BKT dhe Krist Bakiu. Vlera e depozitës 20.000 usd. Afat maturimi 02.12.2022.
- Kontratë për llogarinë e kursimeve “Fonde për të ardhmen e fëmijës”, në Intesa SanPaolo Bank, çelur më datë 15.12.2006, në emër të Krist Bakiu. Vlera 10.000 usd.

### **Procedura e vlerësimit:**

**BKT**, me postën elektronike, datë 19.01.2024, konfirmon depozitën në emër të Krist Bakiu, me gjendje në datë 10.03.2023, vlerën 20.068 usd. Referuar lëvizjeve bankare, evidentohet se depozita është çelur më datë 09.05.2014, nëpërmjet depozitimit cash 25.000 usd. Shuma është tërhequr cash në datë 02.12.2021, në vlerën 5.070 usd, ndërsa diferenca 20.000 usd është ri investuar në depozitë me afat.

**Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.09.2023, konfirmon se shtetasi Krist Bakiu ka patur depozitë të çelur në datë 15.12.2006, nëpërmjet depozitimit cash nga Etleva Bakiu të shumës 10.000 usd, vlerë e cila në datën 20.01.2012 është tërhequr cash në vlerën 11.401 usd.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se depozita e djalit Krist Bakiu me vlerë 10.000 usd, ka patur si burim financiar te ardhurat nga kursimet familjare, pagesat si ekspert në institucionet ndërkombëtare dhe OJF-të si dhe ndihma nga gjyshërit në vlerë 1.000 usd.

Depozita e çelur ne vitin 2014 ka si burim financiar vlerën 11.880 usd që djali Krist Bakiu kishte përfituar nga depozita Futura që atij i ishte hapur në Bankën Shqiptaro Amerikane në vitin 2006 si dhe nga tërheqja e depozitës së bashkëshortes Etleva Bakiu në Credins Bank, në shumën 15.647 usd, çelur ne vitin 2012 dhe tërhequr ne vitin 2014.

Shtetasja Etleva Bakiu ka patur depozitë me afat 2 vjeçar pranë Credins Bank, çelur më datë 16.03.2012, nëpërmjet depozitimit cash me vlerë 15.000 usd. Depozita është tërhequr cash më datë 18.03.2014, në vlerën 15.647 usd. (trajtuar më sipër).

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.***

***Vlera prej 25.000 usd, depozituar më datë 09.05.2014, ka si burim depozitat e krijuara përpara vitit 2008, për të cilat aplikohet neni 32, pika 1.1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.***

### **Deklarimi i të ardhurave nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit**

- ❖ Të ardhura nga paga në Universitetin Luarasi, Fakultetin Ekonomik, Organizatën për Menaxhimin e Destinacionin Korçë, për periudhën 01.01.2019 - 31.01.2023. Shuma e të ardhurave 4, 080, 959 lekë. **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH për Krist Bakiu, i cili ka realizuar të ardhura për periudhën gusht 2014 pranë subjektit Stavri Marko; mars 2018 - janar 2023 pranë Kolegjit Universitar Luarasi, janar 2022 - janar 2023 pranë Org. Menaxhimit e Destinacionit Korçë. Gjithashtu ka përfituar pagesa nga Fakulteti Ekonomik.

### **Procedura e vlerësimit:**

**BKT**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon llogari në emër të Krist Bakiu dhe pagat e kredituara gjatë periudhës 06.11.2018 - 10.03.2023 nga Universiteti Luarasi, si dhe pagesa të ndryshme nga Fakulteti Ekonomik dhe Qendra Young Shapers of Alb, në vlerën totale prej 3.315. 000 lekë.

Konfirmohen interesat bankar, realizuar gjatë periudhës së maturimit të depozitës së çelur në datë 09.05.2014 , për vitin 2014, vlera 1.074 usd; për vitin 2018, vlera 579 usd; për vitin 2020, vlera 467 usd.

Gjithashtu nëpërmjet BKT, konfirmohen pagesat kundrejt detyrimit tatimor për periudhën janar – dhjetor 2020, në vlerën 3.900 lekë, debituar më datë 28.06.2021, si dhe 3.900 lekë më datë 13.04.2022 për periudhën tatimore janar - dhjetor 2021.

**Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.09.2023, konfirmon llogari në emër të shtetasit Krist Bakiu në të cilën janë kredituar pagesa nga Org. për Menaxhimin e Destinacionit Korçë, për periudhën mars - dhjetor 2022, në shumën totale rreth 360.000 lekë. Gjithashtu, konfirmohen interesat neto në vlerën 1.400 usd, përfituar si rezultat i investimit të kryer në depozitën datë 15.12.2006, me vlere 10.000 usd.

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2023, konfirmon llogari në emër të Krist Bakiu dhe pagat e kredituara gjatë periudhës 13.04.2018 - 05.10.2018 nga Kolegji Universitar Luarasi, në shumën totale prej 136.600 lekë.

**Instituti i Sigurimeve Shogërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se shtetasi Krist Bakiu ka realizuar të ardhura gjatë periudhës mars 2018 - mars 2023 pranë Kolegjit



Universitar Luarasi/Universiteti Luarasi. Gjithashtu ka përfitur pagesa nga Fakulteti Ekonomik si dhe nga Org. Për Menaxhimin e Destinacionit Korçë (janar 2022 - mars 2023).

### **Konkluzion:**

- *Të ardhurat e djalit nga paga, për periudhën nëntor 2018 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 3.812.000 lekë.*
- *Të ardhurat e djalit nga interesat bankar, për periudhën 2006 - 2023, konfirmohen në vlerën totale 3.520 usd, konvertuar rreth 379.000 lekë.*
- *Nga verifikimi i llogarive bankare, rezulton se personi i lidhur me subjektin e vlerësimit ka paguar detyrimet tatimore lidhur me dypunësimin në vlerën 7.800 lekë.*

### **DEKLARIMI I VAJZËS – KETI BAKIU**

#### **Deklarimi i pasurisë**

1. Llogari shumë emërore me babain tim në Tirana Bank, me gjendje në datë 24.02.2023, në vlerën 3.144,37 euro. Pjesë takuese 100%. **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Lëvizjet e llogarisë në emër të Keti Bakiu pranë Tirana Bank, gjatë periudhës 06.01.2020 - 24.02.2023. Gjendje në llogari në datë 24.02.2023, në vlerën 3.144,37 euro. **Trajtuar më lart.**

#### **Shkresat e institucioneve**

**Banka e Shqipërisë**, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Fibank, Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, LandesLease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, AK Invest, EasyPay, Fondi Besa, NOA sha, IUTE Credit, Kredo.al, konfirmojnë se **subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, ç'ka konfirmohet me deklarinimin.**

**Drejtoritë Vendore të ASHK-së**, Kamëz Vorë, Tirana Jug, Rurale 1, Rurale 2, Zonave të Stimuluara, Lushnjë, Mallakastër, Kuçovë, Malësi e Madhe, Gramsh, Kavajë, Kukës, Elbasan, Kolonjë, Skrapar, Has, Durrës, Pukë, Bulqizë, Përmet, Tropojë, Mirditë, Tepelenë Sarandë, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Pogradec, Devoll, Fier, Mat, Krujë, Librazhd, Peqin, Korçë, Dibër, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit.

**OTP Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Bakiu ka patur llogari pranë bankës. Gjatë periudhës 02.03.2009 - 03.04.2018, nuk janë kryer transaksione bankare.

**Unioni Financiar Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.08.2023, konfirmon se shtetasja Keti Bakiu ka përfitur/tërhequr 6 transaksione me vlerë totale 670 euro.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se, këto transaksione, vajza Keti Bakiu i ka kryer me vetveten, domethënë nga llogaria e saj në Belgjikë, i'a ka dërguar vetes në Shqipëri, për të përballuar shpenzimet e vogla kur vinte me pushime.

- ***Subjekti dha sqarime lidhur me konfirmimin e Unionit Financiar.***

**AK Invest**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.08.2023, konfirmon se shtetasja Etleva Bakiu (jo klient) ka kryer dërgesa jashtë territorit të Shqipërisë, nga Italia.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024 subjekti sqaroi se këto dërgesa nuk janë bërë nga bashkëshortja Etleva Bakiu, por person tjetër. Për këtë është aplikuar për sqarim pranë AK Invest dhe përgjigja zyrtare është që këto dërgesa nuk janë kryer nga bashkëshortja Etleva Veli Bakiu. Kjo vërtetohet edhe nga tabela me lëvizjet jashtë vendit, ku bashkëshortja në atë kohë ka qenë në Shqipëri. **Paraqiti:**

- Vërtetim nr. 125 prot., datë 26.01.2024, nga AK Invest, në të cilin konfirmohet se shtetasja Etleva Bakiu, e datëlindjes 28.11.1963, nr. Identifikimi G\*\*\*V, nuk ka kryer transaksione nëpërmjet rrjetit AK Invest. Nuk administrohen të dhëna për transfertat e kryera jashtë vendit.

• *Subjekti dha sqarime lidhur me konfirmimin e AK Invest.*

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 15.08.2023 nuk konfirmon automjete të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

**Regjistri Noterial Shqiptar, Ministria e Drejtësisë**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 23.04.2024, ka përcjellë informacionin për të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të regjistruara në sistemin RNSH, për periudhën 01.03.2013 deri në datën 12.09.2023, të kryera nga noterë të ndryshëm për subjektin dhe personat e lidhur me të.

Nga verifikimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga institucioni përkatës, ka rezultuar se:

Më datë 10.06.2013, pranë noteres Sh.Gj, është nënshkruar kontratë nr. rep.,7256, nr. kol., 5196, datë 10.06.2013, ndërmjet palëve Besnik Ferit Bakiu (Pala blerëse) dhe M. H. A (Pala shitëse).

Nga këqyrja e kontratës palët deklarojnë se njihen personalisht me njëri tjetrin dhe se kanë rënë në marrëveshje me tyre për shitblerjen e një automjeti me këto të dhëna:

**Lloji:** Autoveturë

**Marka:** Mercedes Benz

**Tipi:** 300D

**Targa:** TR 4\*\*I

**Nr. i Shasisë:** WD\*\*\*A416396

**Viti i Prodhimit:** 1987

Pronësia vërtetohet me të gjithë dokumentacionin e plotë ligjor në shumën 100.000 lekë, dhe se palët deklarojnë se janë likuiduar mes tyre për këtë shumë shitblerje, dhe se nuk kanë më asnjë lloj detyrimi as tani, as në të ardhmen.

Pala blerëse deklaron se është dakord dhe se e ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë, objekt shitblerje dhe se nuk ka asnjë lloj pretendimi për gjendjen faktike të këtij automjeti.

Me këtë veprim të bërë mes palëve, zhvishet nga pronësia mbi këtë automjet pala shitëse dhe njihet pronar i vetëm ligjor pala blerëse.

Lidhur me këtë automjet, subjekti i vlerësimit konfirmon të dhënat e administruara nga institucioni përkatës, duke u shprehur se burim i të ardhurave për blerjen e tij kanë qenë kursimet familjare.

Gjithashtu subjekti ka deklaruar se më datë 18.07.2013, automjetin e vodhën në vendin e parkimit dhe menjëherë pas konstatimit të vjedhjes ka bërë denoncim në Komisarriatin e Policisë nr.2 në DVP Tiranë.

Trupa e Vlerësimit ka kryer një hetim objektiv lidhur me këtë automjet, duke përdorur sistemet e Policisë së Shtetit si dhe dërguar shkresë institucionit përgjegjës, konkretisht DVP Tiranë, me nr. \*\*\*, prot., datë 18.04.2024.

**DVP Tiranë**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 24.04.2024, ka dërguar praktikën për shpalljen në kërkim të automjetit me targë TR 4\*\*\*I.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se DVP Tiranë, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 26.07.2013, shpall në kërkim automjetin tip Mercedes Benz, viti 1987, me targë TR 4\*\*\*I, ngjyrë e bardhë, me nr. shasie WD\*\*\*A416396, në pronësi të shtetasit Besnik Ferit Baku, i datëlindjes 29.07.1960, lindur në Berat, e banues në Tiranë, pasi më datë 18.07.2013, ora 09:00, ka bërë kallëzim në Komisarriatin e Policisë nr. 2, Tiranë, shtetasi Besnik Baku për vjedhjen e automjetit nga persona të paidentifikuar në rrugën e Kavajës, pranë 21 dhjetorit, gjatë natës.

**DPSHTRR**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 23.04.2024, ka bashkëlidhur fotokopje të dokumentacionit të automjetit me targë TR 4\*\*\*I, e konkretisht:

- Leja e qarkullimit rrugor dhe të dhënat lidhur me të në emër të M. H. A, regjistruar më datë 12.06.2009.
- Certifikatë e kontrollit fizik të mjetit, lëshuar z. M. A më datë 15.06.2009.
- Dokument hyrje i automjetit tip Benz me targë H\*\*\*98, datë 10.05.2004.
- Vërtetim çdoganimi datë 10.05.2004.
- Librezë automjeti, bashkëlidhur faturë çdoganimi.

### **Konkluzion:**

- *Në përfundim të hetimit administrativ, rezulton se subjekti i vlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me targë TR4\*\*\*I në vitin 2013, blerë sipas kontratës me nr. rep.,7256, nr. kol., 5196, datë 10.06.2013, në vlerën 100.000 lekë, me kursime familjare.*
- *Deklarimi i subjektit të vlerësimit, përputhet me përgjigjet e institucioneve përkatëse.*
- *Subjekti i vlerësimit, referuar analizës financiare, ka pasur të ardhura të mjaftueshme me qëllim blerjen e automjetit në vitin 2013 në vlerën 100.000 lekë.*

**QKB**, me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 14.08.2023, konfirmon se shtetasi Besnik Baku dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të jenë pajisur me NIPT, si persona fizikë apo të zotërojnë kuota në shoqëri tregtare.

**Drejtoria e Përgjithshme Tatimore**, me shkresën nr. V-prot, datë 21.08.2023 dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 25.08.2023, konfirmojnë se shtetasi Besnik Baku, rezulton i regjistruar më datë 28.12.2011, si administrator pranë Qendrës Rajonale për Parandalimin e Krimit, me NIPT L\*\*\*V, organizatë jo fitimprurëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga ISSH, rezulton se shtetasi Besnik Baku, është i regjistruar si punëmarrës pranë kësaj organizate, por nuk janë realizuar të ardhura gjatë periudhave respektive.

Me procesverbalin e datës 29.01.2024, subjekti sqaroi se e ka pezulluar faktikisht veprimtarinë e kësaj qendre dhe bëhen vetëm pagesat vjetore të taksave. Sipas statutit të kësaj OJF, ai nuk ka të drejtë ta mbyll veprimtarinë, apo të caktoj një administrator tjetër. Këtë të drejtë e ka bordi. Por ka vite që nuk ka kontakte me anëtarët e bordit, pasi njëri nga ata ka ndërruar jetë dhe tjetri është jashtë vendit.

- **Subjekti dha sqarime lidhur me konfirmimin e DPT/DRT Tiranë.**

**Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën \*\*\* prot., datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të Besnik Baku dhe personave të lidhur me të.

**Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6, të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:**

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;**
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;**
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.**

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

🚩 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në këto elementë:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;

- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- Procedura verifikuese nga Trupa e Vlerësimit që konsiston në:
  - verifikimin e informacioneve në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
  - identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale;
  - analizimin dhe kryqëzimin e dokumentacionit të administruar, me deklaratimet e subjektit të vlerësimit.

## **Deklarimi i subjektit të vlerësimit**

### **Në deklaratën e kontrollit të figurës, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se:**

- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshortja, fëmijët, si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare, janë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.

- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga ç'rregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas Ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

### **Procedura verifikuese**

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36 dhe 37, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e tjera duke kërkuar të dhëna nga institucionet përgjegjëse, të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

**Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 29.08.2023, bën me dije se:

Nuk ka ndryshim në përbërësit e gjendjes civile. Nga lindja e deri më datë 08.10.1991, ka rezultuar i regjistruar në zyrën e gjendjes civile në Bashkinë Berat. Nga data 08.10.1991 e në vijim, rezulton i regjistruar banor i Njësisë Administrative nr. 7, Bashkia Tiranë.

**Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresë \*\*\*, prot., datë 22.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku, bën me dije se nuk rezulton i dënuar.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 07.09.2023, ka konfirmuar të dhëna referuese, ku përfshihet subjekti i vlerësimit Z. Besnik Baku.

Nga verifikimi konstatohet se:

- Subjekti i vlerësimit nuk rezulton të ketë kryer veprimtari të paligjshme.
- Nuk ka patur vijueshmëri të situatës.
- Nuk rezulton që në emër të subjektit të vlerësimit të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
- Nuk ka fakte apo prova që subjekti i vlerësimit është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë që ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 01.09.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se **nuk kanë**:

- Të dhëna për cenimin e figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta,
- Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar,
- Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale,
- Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autorit shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale,
- Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj,
- Të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s,
- Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale,
- Të dhëna nëse subjekti ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
- Procedim disiplinor apo masë disiplinore.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 25.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

**Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**, me shkresat e datës 16.08.2023, shkresën nr. \*\*\*, dhe shkresën nr. \*\*\*, datë 03.10.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm.
- Nuk disponohen ankesa, të dhëna apo informacione që lidhen me objektin e kërkesës.
- Me shkresë nr. \*\*\*, datë 08.10.2013, është referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, materiali kallëzues në ngarkim të disa punonjësve policie, midis të cilëve dhe subjekti i vlerësimit Z. Besnik Baku, të dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.

Trupa e Vlerësimit ka kryer verifikime lidhur me materialin referues në ngarkim të subjektit të vlerësimit, nga ku rezulton se nga ana e Prokurorisë Tiranë është marrë vendim mosfillimi.

**Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku, bën me dije se:

- Nuk është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të vlefshme.
- Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

**Institucionet Ligjzbatuese**, me shkresat nr. \*\*\*, prot., datë 28.08.2023 dhe datë 31.10.2023, bëjnë me dije se për subjektin e vlerësimit:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal,
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale,

- Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale,
- Nuk ka patur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 07.05.2024, bën me dije se për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të sipas certifikatës familjare, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

**Avokati i Popullit**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 21.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 24.11.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku, bën me dije se nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, si dhe anëtarë, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish – Sigurimi i Shtetit, deri në 2 korrik 1991.

**Agjencia e Inteligjencës Financiare**, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku, dhe personat e lidhur me të, rezultuan raportime financiare, të cilat u verifikuan nga Trupa e Vlerësimit dhe u konstatua se ishin veprime bankare rutinë dhe jo të dyshimta.

#### **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore, “Për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike”, ka kryer ekspertimin toksikologjik të një mostre urine, mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike.

Me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 14.05.2024, protokolluar me nr. \*\*\*, prot., datë 20.05.2024, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar dokumentacionin përkatës, analizuar dhe vlerësuar nga Trupa e Vlerësimit, konkretisht:

- Akt Ekspertimi Toksikologjiko – Ligjor nr. \*\*\*, datë 14.05.2024 për subjektin e vlerësimit Besnik Baku.
- Deklaratë Eksperti

*Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit Z. Besnik Baku, aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.*

#### **Denoncimet nga publiku**

Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin/veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur.



## **Konkluzion:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, arriti në konkluzionin se:

- *Lidhur me të dhënat referuese në ngarkim të subjektit të vlerësimit, rezulton se janë ndarë me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe nuk ka pasur vijimësi, nuk ka fakte apo prova që subjekti i vlerësimit është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë që ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*
- *Sa i përket faktit të mos pajisjes me Certifikatë të Sigurisë së Personelit, funksioni që ushtron subjekti i vlerësimit aktualisht, nuk përfshihet në listën e funksioneve organike që mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar.*
- *Sa i përket materialit kallëzues në ngarkim të subjektit të vlerësimit, rezulton se organi kompetent ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal, si dhe ndaj subjektit nuk rezulton të ketë procedime penale në ngarkim.*
- *Informacionet e ardhura nga institucionet përgjegjëse, përputhen me deklarin e subjektit.*
- *Nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur.*
- *Nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.*

**Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3, të nenit 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:**

- a) punonjësi nuk ka kryer deklarin të rremë;**
- b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;**
- c) nuk ka informacion në deklarin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

## **C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjisllacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në këto elemente:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Procedura verifikuese nga Trupa e Vlerësimit, e cila konsiston në analizimin dhe kryqëzimin e informacioneve të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, me deklarin e subjektit të vlerësimit.

## **Deklarimi i subjektit të vlerësimit**

Në formularin e aftësive profesionale subjekti deklaron:

### **Të dhëna për Arsimimin**

- Arsim i Lartë Policor, Akademia e Rendit Publik, Viti 1980 – 1983.
- Instituti i Lartë i Rendit Publik, Viti 1991 – 1992.
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik Tiranë, Viti 1989 – 1992.

### **Procedura e vlerësimit:**

Subjekti i Vlerësimit ka filluar studimet pranë Akademisë së Rendit Publik, në vitin 1980 dhe i ka përfunduar në vitin 1983. Në përfundim, institucioni arsimor përkatës, e ka titulluar “Specialist i lartë policie”, duke u pajisur me diplomën nr. A, datë 09.07.1983.

Në periudhën 1989 – 1992, subjekti i vlerësimit ka kryer studimet e larta në Fakultetin Juridik, Universiteti i Tiranës, dega Drejtësi, ku është diplomuar duke u pajisur me diplomën përkatëse nr.2233, datë 06.07.1992.

Në periudhën 1991 – 1992, subjekti i vlerësimit ka studiuar në Institutin e Lartë të Rendit Publik, duke u pajisur me diplomën përkatëse.

*Sipas legjislacionit për Policinë e Shtetit ndër vite dhe Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.*

### **Të dhëna për Punësimin dhe ecuria në karrierë**

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Neni 45, pika 2, shkronja (dh), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit, në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve etj., të cilat janë marrë në analizë nga Trupa e Vlerësimit, me qëllim vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit, konkretisht:

- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. \*\*\*, datë 19.05.2017, për Drejtues Besnik Ferit Bakiu, me detyrë Shef Sektori, në Sektorin e Trajnimit dhe Përgatitjes, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Shef Sektori, në Sektorin e Trajnimit dhe Përgatitjes, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*
- *Kopje e Urdhrit nr. \*\*\*, datë 16.11.2022, për Drejtues Besnik Ferit Bakiu, me detyrë Shef Sektori, në Sektorin e Trajnimit dhe Përgatitjes, në Departamentin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i shpallur fitues, dhe përfunduar trajnimin për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”, i jepet grada “Drejtues i Parë” dhe për ndryshim strukture, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Drejtor, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*

Në formularin e aftësive profesionale, plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit, rezulton se 5 vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

Nga data 01.06.2017 – 16.11.2022, subjekti i vlerësimit Z. Besnik Bakiu ka ushtruar funksionin si Shef Sektori, në Sektorin e Trajnimit dhe Përgatitjes, në Departamentin e Burimeve Njerëzore, emëruar me Urdhër nr. 287, datë 19.05.2017.

Nga data 17.11.2022 dhe aktualisht, subjekti i vlerësimit ushtron funksionin si Drejtor, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, emëruar me urdhrat respektiv të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Sa i përket dhënies së gradës policore, nga “Drejtues” në “Drejtues i Parë”, me Urdhër nr. 2538/1, datë 16.11.2022, Trupa e Vlerësimit mori në analizë kuadrin ligjor përkatës në kohën e veprimtimit të tij dhe dokumentacionin e administruar nga dosja personale, e konkretisht:

- *Shkresë nr. \*\*\*, datë 04.05.2022 “Dërgojmë procesverbalin e provim certifikimit për fitimin e gradës “Drejtues i Parë” në Akademinë e Sigurisë.*
- *Urdhër nr. 2538/1, datë 16.11.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku përmendet se Drejtues Besnik Ferit Bakiu i jepet grada policore “Drejtues i Parë”.*
- *Urdhër nr. \*\*\*, datë 22.04.2022 “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për dhënie grade të aplikantëve fitues për fitimin e gradës policore “Drejtues i Parë”.*

Sa më sipër rezulton:

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, është miratuar VKM nr. 892, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, dhe VKM nr. 531, datë 29.07.2022, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin

*për gradat në Policinë e Shtetit*”, ku përcaktohen funksionet korresponduese për çdo gradë si dhe ekuivalentimin e tyre. Po ashtu është miratuar edhe VKM nr. 750, datë 16.09.2015, që miratonte Rregulloren e Personelit të Policisë së Shtetit. Sipas kësaj rregulloreje, e cila zbatonte Ligjin e ri të Policisë së Shtetit, si dhe ndër të tjera rregullat e marrëdhënies së punës, që nga rekrutimi i punonjësve të Policisë së Shtetit, trajnimin në shkollën bazë të Policisë së Shtetit, ecurinë në karrierë, në gradë etj, Trupa e Vlerësimit gjen të bazuar sipas dispozitës ligjore që përcakton kjo rregullore specifikisht se :

“Neni 161/1”, pika 1, “Kriteret për aplikim për gradimin e radhës”, i Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015 përcakton se:

Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës policore të radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës), jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
- b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në Ligjin “Për Policinë e Shtetit”;
- c) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;
- ç) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;
- d) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

“Neni 161/2”, pika 1, “Afatet e qëndrimit në gradë” përcakton se:

Punonjësi i Policisë, për të aplikuar për gradën e radhës, duhet të plotësojë afatet e mëposhtme:

- a) nga “Inspektor” deri në “Inspektor i dytë”: 5 vjet;
- b) nga “Inspektor i dytë” në “Inspektor i parë”: 10 vjet;
- c) nga “Nënkomisar” në “Komisar”: 3 vjet;
- ç) nga “Komisar” në “Kryekomisar”: 3 vjet;
- d) nga “Kryekomisar” në “Drejtues”: 5 vjet;
- dh) nga “Drejtues” në “Drejtues i parë”: 3 vjet.

Në VKM nr. 892, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, përcaktohen funksionet që i korrespondojnë gradat përkatëse.

Bazuar në këto përcaktime, Trupa e Vlerësimit konstaton se, subjekti ka plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 161/1, të VKM nr. 750, datë 16.09.2015, me qëllim aplikimin për gradën nga “Drejtues” në “Drejtues i Parë”.

Subjekti i Vlerësimit Z. Besnik Baku, ka aplikuar për gradën e rradhës duke plotësuar afatet e qëndrimit në gradë, konkretisht 8 vite (2014 – 2022).

Grada “Drejtues”, korrespondon me funksionet që subjekti i vlerësimit ka ushtruar për periudhën 2017 – 2022, sipas përcaktimeve të VKM nr. 892, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”.

Grada “Drejtues i Parë”, korrespondon me funksionin që subjekti i vlerësimit ushtron aktualisht si Drejtor, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve të VKM nr. 531, datë 29.07.2022 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të policisë së shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

### **Konkluzion:**

- *Lidhur me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit Z. Besnik Bakiu, arrijmë në konkluzion se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*

### **Vlerësimet e punës**

Në aktet e depozituara pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, rezulton se gjatë 5 viteve të fundit 2018 - 2013, janë të administruara 5 vlerësime të aftësive individuale të subjektit të vlerësimit Z. Besnik Bakiu, konkretisht:

- Për vitin 2018, është vlerësuar me 27 pikë;
- Për vitin 2020, është vlerësuar me 27 pikë;

### **Konkluzion:**

- *Nga analizimi i vlerësimeve të mësipërme, konstatohet se për periudhën 2018 – 2022, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga eprori i drejtpërdrejtë pothuajse me pikët maksimale, (27 pikë nga 28 total).*
- *Nga verifikimet, ka rezultuar se për vitin 2019, vitin 2021 dhe vitin 2022, nuk është administruar vlerësimi i punës në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit.*

### **Përmbushja e detyrave të kryera dhe respektimi i rregullave të etikës**

Sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, neni 43, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përmbushja e detyrave nga punonjësi.

Gjithashtu në nenin 45, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se aftësitë profesionale të punonjësit, vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

Nga verifikimi i dosjes së personelit si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 2018 – 2023, subjekti i vlerësimit nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore.

## **Konkluzion:**

*Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të subjektit, konkludojmë se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.*

## **Kualifikimet dhe trajnimet:**

Nga verifikimi i dosjes së personelit të subjektit të vlerësimit kalimtar Z. Besnik Bakiu, si dhe formularit të aftësive profesionale të plotësuar nga subjekti, rezulton se për periudhën objekt vlerësimit, nuk është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit (2018-2023), por rezulton se gjatë gjithë karrierës së tij si punonjës policie ka kryer mjaftueshëm trajnime me qëllim kualifikimin për funksionin që mban, gjithashtu i janë dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit certifikata për shërbime të dalluara dhe certifikata të karrierës.

Subjekti i vlerësimit ka marrë pjesë në workshop dhe konferenca jashtë vendit, dhe dokumentacioni justifikues është administruar nga Trupa e Vlerësimit.

## **Konkluzion përfundimtar:**

Në përfundim të verifikimeve të kryera nga Trupa e Vlerësimit lidhur me vlerësimin profesional arrihet në konkluzionin se:

- *Subjekti i vlerësimit, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.*
- *Funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*
- *Për vitin 2018 dhe vitin 2020, subjekti i vlerësimit është vlerësuar pozitivisht nga eprori i drejtpërdrejtë.*
- *Për vitin 2019, vitin 2021 dhe vitin 2022, nuk është administruar vlerësimi i punës në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit.*
- *Subjekti i vlerësimit nuk është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit (2018-2023), por rezulton se gjatë gjithë karrierës së tij si punonjës policie ka kryer mjaftueshëm trajnime me qëllim kualifikimin për funksionin që mban*
- *Subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.*

Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1, të nenit 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:

- a) është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- b) ka vlerësime pozitive pune;
- c) ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

## **KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR:**

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Besnik Ferit Baku, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollin e figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

## **PËR KËTO ARSYE:**

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës “1” dhe “2” të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar,

## **VENDOSI:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Z. Besnik Ferit Baku, me funksion Drejtor, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*Ky vendim u shpall sot më datë 26.09.2024, në Tiranë.*

## **TRUPA E VLERËSIMIT**

**KRYESUESE**

**Bora VRENJO**

**RELATOR**

**Henri NAQELLARI**

**ANËTARE**

**Loreta HANXHARI**

***Aneks 1: Analiza financiare për subjektin e vlerësimit Z. Besnik Baku***

Burimi/Viti	Pasqyra e Analizes Financiare													
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	10.03.2023
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit	1,136,781	1,754,087	2,270,451	2,023,501	1,676,117	1,913,634	2,440,708	2,595,576	4,243,990	4,117,451	4,149,588	3,256,146	3,761,658	447,548
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme														
Të ardhura nga depozitat	3,144,984		1,105,897		5,940,670			1,320,345			5,494,278	491,800		
<b>Totali i të Ardhurave neto</b>	<b>4,281,765</b>	<b>1,754,087</b>	<b>3,376,348</b>	<b>2,023,501</b>	<b>7,616,787</b>	<b>1,913,634</b>	<b>2,440,708</b>	<b>3,915,921</b>	<b>4,243,990</b>	<b>4,117,451</b>	<b>9,643,866</b>	<b>3,747,946</b>	<b>3,761,658</b>	<b>447,548</b>
Detyrime: Te hyra nga huate/kredi/dhurim							700,000				500,000			
Shpenzime jetike sipas INSTAT	426,504	853,008	558,192	558,192	944,568	953,484	982,740	970,500	1,028,868	1,106,712	1,118,700	1,138,608	1,188,144	198,024
Shpenzime per Qera														
Shpenzime për Mjekim														
Shpenzime për Arsimimin							253,125			1,466,520	1,149,500	1,089,000	1,318,900	
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit													291,000	
Detyrime Kredie Bankare Leasing, etj							76,562	122,439	134,338	366,657	125,278	163,318	179,715	31,689
Shpenzime dhe te dala te tjera.														
<b>Totali i shpenzimeve dhe te dalave</b>	<b>426,504</b>	<b>853,008</b>	<b>558,192</b>	<b>558,192</b>	<b>944,568</b>	<b>953,484</b>	<b>1,312,427</b>	<b>1,092,939</b>	<b>1,163,206</b>	<b>2,939,889</b>	<b>2,393,478</b>	<b>2,390,926</b>	<b>2,977,759</b>	<b>229,713</b>
Investime,pasuri				100,000										
Likuiditete			3,771,021		5,705,750		314,121					2,060,000		1,021,073
Gjendje Cash														1,210,000
<b>Totali Pasuri</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>3,771,021</b>	<b>100,000</b>	<b>5,705,750</b>	<b>-</b>	<b>314,121</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2,060,000</b>	<b>-</b>	<b>2,231,073</b>
Mundësia per Kursime	3,855,261	4,756,340	3,803,475	5,168,784	6,135,253	7,095,403	8,609,563	11,432,545	14,513,329	15,690,891	23,441,279	22,738,299	23,522,198	21,508,960